

ATENTAT NE MITROVICE

Vritet politikani serb në Kosovë, Oliver Ivanoviç

Situatë e tensionuar, Beogradi tërheq delegacionin e negociatave nga Brukseli. Kosova, Shqipëria, ndërkombëtarët dënojnë ashpër aktin

► FAQE 8-9



ZHDUKJA E ARTAN LLESHIT

Dëshmia e vëllait të të zhdukurit: Si më vranë babain e xhaxhanë

Albert Lleshi rrëfen se dyshon se i vëllai është rrëmbyer dhe vrarë për hasmërinë në Angli

ELTON QYNO

► FAQE 7

[SHQIPTARJA.com]

EDICIONI MULTIMEDIAL

Lexoni Dëgjoni Shikoni

Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË | VITI VIII - NR. 11 | E MËRKURË, 17-01-2018 | www.shqiptarja.com

INTERVISTA NE REPORT TV



Jozefina Topalli: Rama-Basha po qeverisin sipas paktit të 18 majit

"Lulzim Basha është bërë ortak i oligarkëve, marrëveshja e 18 majit ishte për 14 milionë eurot e pallatit të vjehrrit"

ERNETA SHEVROJA

► FAQE 4

MARREVESHJA RAMA-BASHA

DOKUMENTI I PS, PAKTI I 18 MAJIT KA PERFUNDUAR QE NE NENTOR

Kreu i grupit të PS në kërkesën e 14 nëntorit për shkarkimin e Zgurit deklaroi marrëveshjen e prishur

► FAQE 2-3



Ish të përndjekurit

TRASHEGIMTARET, KUSH PRITET TE MOS MARRE DEMSHPERBLIMIN

Ndërpritet procesi i dëmshpërblimeve. Skemat që po diskutohen nga qeveria për ish të përndjekurit politik

► FAQE 14

KAMPIONIA E BOTES

Tronditet peshëngrita, Romela Begaj del pozitive me doping

► FAQE 10

SHKELJET NE FSHF

Flamurtari kallëzon Dukën në Prokurori për shoqatat fantazmë

► FAQE 11



AUTORET FRANCEZE

Profeci e Apollinaire: Kruja, kryeqyteti i Skënderbeut, themel i një Europe të re

NGA FOTAQ ANDREA

► FAQE 12-13

Cyan magenta yellow black

Lulzim Basha: Sakrifikuam interesat tona me paktin e 18 Majit

"Në 27 Janar shumica e shqiptarëve do të tregojnë se nuk pajtohen me aleancën e krimit të ndërtuar nga Edi Rama"



Adriatik Doçi
TIRANE

REFORMA

"E pra ky është një akt i përgjegjshëm politik, i cili bëhet për t'ia davaritur çdokujt dyshimin se Partia Demokratike ka ndonjë axhendë tjetër përveç se përshpejtimit të Reformës në Drejtësi".

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, gjatë një takimi me përfaqësues të disa degëve të Tiranës, komentoi marrëveshjen e 18 Majit. Basha tha se opozita sakrifikoi interesat e saj me marrëveshjen e 18 Majit. "Ne jemi njerëzit që kemi ditur të sakrifikojmë edhe interesat tona politike dhe partiake, siç ishte marrëveshja e 18 Majit, për interes të Shqipërisë ndaj nuk shkojmë për karrigen tonë. Nuk shkojmë për të bërë Lulzim Bashën kryeministër. Shkojmë për të çliruar Shqipërinë nga krimi. Për të çliruar drejtësinë nga krimi! Për të çliruar qeverinë nga krimi, për të çliruar ekonominë nga krimi. Vetë protesta do të jetë numerikisht, shumë e shumë herë më e madhe se bashkimi i kopukëve dhe horrave e kriminelëve të Edi Ramës, ndërsa zëri i protestës, do të jetë zëri i shumicës absolute të shqiptarëve", tha Basha.

NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha shtroi se nisma e opozitës për zgjedhjen e një Prokurori të Përgjithshëm sipas Kushtetutës dhe me Vetting është treguesi më i qartë i vullnetit të opozitës për zbatimin e Reformës në Drejtësi, të pakapur nga krimi. "E pra ky është një akt i përgjegjshëm politik, i cili bëhet për t'ia davaritur çdokujt dyshimin se Partia Demokratike ka ndonjë axhendë tjetër përveç se përshpejtimit të Reformës në Drejtësi. Se afërmendsh, opozita nuk ka dhe nuk mund të ketë aleatë më të mirë në luftën kundër krimit dhe kriminelëve dhe të korruptuarve, se sa një drejtësi që funksionon", u shpreh Basha. Kreu i opozitës tha se, nëpërmjet kryeprokurorit antikushtetues, Rama synon të bllokojë hetimet për Saimir Tahirin dhe të diktojë zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të kontrolluar më pas edhe Prokurorinë e Posaçme për luftën kundër krimit dhe korrupsionit, duke shkatërruar themelet e Reformës në Drejtësi. "Saimir Tahiri kapet nga antimafia duke përfituar dhjetëra, mijëra euro varëse e byzylykë floriri. 5 milionë euro në muaj nga trafikantët e drogës, dhe Edi Rama ndalon arrestimin e tij. Përse? Fare e thjeshtë, sepse arrestimi i Saimir Tahirit, është hapi i parë drejt arrestimit dhe vënien para drejtësisë të Edi Ramës, si koka dhe arkitekti i kanabizimit dhe kriminalizimit të Shqipërisë. Po mbron veten e tij. Kaq e thjeshtë është", tha Basha.

MARRËVESHJA

"Ne jemi njerëzit që kemi ditur të sakrifikojmë edhe interesat tona politike dhe partiake, siç ishte marrëveshja e 18 Majit, për interes të Shqipërisë ndaj nuk shkojmë për karrigen tonë".

PROTESTA E 27 MAJIT

Lulzim Basha tha se protesta e 27 Majit nuk është një manifestim për interesin e një force politike, por për t'i dhënë zë shumicës së shqiptarëve. Kreu i opozitës shprehu bindjen se në protestë shumica e shqiptarëve do të tregojnë se nuk pajtohen me aleancën e krimit të ndërtuar nga Edi Rama, që po i varfëron çdo ditë dhe po e bën jetën e familjeve shqiptare më të pasigurtë. "John Lennon, me këngën e tij të famshme "Ëar is over, if you ëant it", "Lufta mbaron po të duash ti". Edi Rama mbaron, po të duash ti! Ky është mesazhi që do t'i japim çdo shqiptari. Po të duash ti, po të duam ne, Edi Rama mbaron! Ky është mesazhi i protestës. Po të ngrihet populli, po të bashkohen qytetarët, Edi Rama mbaron!", tha Basha.

27 janari

Monika Kryemadhi: Policia të mos provokojë



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi mohon të ketë një skenar dhune nga opozita në 27 Janar, por paralajmëron që të mos provokojë protestuesit. "Shqiptarët janë aq të lodhur dhe zhgënjyer sa i përket situatës politike. Në 27 janar protesta do jetë paqësore ku të gjithë shqiptarët që janë të varfër dhe që ndihen të pashpresë, po duan të ikin nga sytë këmbët, i ftojmë që në 27 janar të protestojmë, që t'i tregojmë Ramës që shumica e qytetarëve janë kundër tij. Në imazhin e shqiptarëve është krijuar ideja e protestave të dhunshme, por dhunën e solli z. Rama në 21 janar. Ishte shembulli më i keq i të bërit proteste", u shpreh Kryemadhi.

DËMSHPËRBLIMI / BASHA AKUZA QEVERISË

Basha thirrje ish-të përndjekurve: Ejani në protestë

Kryetari i PD, Lulzim Basha ka zhvilluar një takim në Tiranë me disa degë të partisë në kuadër të organizimit të protestës së 27 janarit kundër qeverisë. Kreu i PD akuzoi qeverinë se në mënyrë të papranueshme po heq familjarët e ish të përndjekurve politike nga e drejta e ligjshme dhe morale e dëmshpërblimit. Basha tha se Arben Ahmetaj dhe Edi Rama do t'u ndërpresin dëmshpërblimin të përndjekurve, kur një ditë më parë i kanë paguar vetës për inceneratorin e Fierit 823 mijë euro. Basha tha se PD do të



qëndrojë kundër çdo përpjekje te qeverisë për heqjen e dëmshpërblimit dhe u bëri thirrje familjeve të ish të përndjekurve dhe pronarëve të bashkohen me opozitën në 27 janar. "I bëj thirrje të gjithë të përndjekurve politikë të bashkohen me ne në 27 janar sepse rruga e vetme është largimi i këtyre kusarëve. Kjo është rruga e vetme për të bërë drejtësi për të përndjekurit dhe për të përmbyllur këtë plagë të madhe morale dhe historike ndaj qindra, mijëra familjeve të cilat po përndiqen për herë të dyte, siç po përndiqen për herë të dytë pronarët me ligjin poshtërues dhe shpronësues. Pronaret, të përndjekurit dhe çdo shqiptar duhet ta dijë se më 27 janar jemi bashkë në shesh për ta në shesh në dhe për të drejtat e tyre të

BASHA

"I bëj thirrje të gjithë të përndjekurve politikë të bashkohen me ne në 27 janar sepse rruga e vetme është largimi i këtyre kusarëve. Kjo është rruga e vetme për të bërë drejtësi për të përndjekurit dhe për të përmbyllur këtë plagë të madhe morale dhe historike".

patjetërsueshme, se nuk do të pranojmë kurrë pazar me gjakun e paraardhësve të tyre, që luftuan për liri në ditët më të errëta të këtij vendi", tha Basha. Kreu i hodhi akuza edhe në adresë të ministrit të Financave, Arben Ahmetajt. "10% e familjeve në Tiranë nuk sigurojnë dot më shumë se një vakt bukë për fëmijët e tyre, por dje Arben Ahmetaj i dha inceneratorit të Fierit 820 mijë euro të tjera paradhënie duke e çuar shifrën totale në 5.8 milionë euro paradhënie për të ndërtuar një fabrikë helmesh, një nga tre fabrikat e helmeve, të cilat, në totaldo t'u kushtojnë shqiptarëve, vetëm vitin e parë", pohoi Basha.



PROPOZIMI / MANJA: JO KOMPROMIS

Ndryshim të Kushtetutës? PS kundër PD-LSI



Manja
"Nuk do të ketë asnjë kompromis mbi Kushtetutën e miratuar me 140 vota. Nesër jemi në ditë normale pune në Komisionin e Ligjeve. Opozita nuk mund të na bllokojë politikisht. Ka mekanizma zhbllokues për komisionin ad hoc".

Partia Socialiste ka reaguar pas kërkesës së opozitës për ndryshimin e Kushtetutës dhe ligjit lidhur me zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, flet për amendimin kushtetues të opozitës dhe KLGJ e KLP. Manja deklaroi prerë se nuk do të ketë asnjë kompromis me opozitën për ndryshime kushtetuese. "Nuk do të ketë asnjë kompromis mbi Kushtetutën e miratuar me 140 vota. Nesër jemi në ditë normale pune në Komisionin e Ligjeve. Opozita nuk mund të na bllokojë politikisht. Ka mekanizma zhbllokues për komisionin ad hoc", tha Manja. Më tej, deputeti socialist deklaroi se mazhoranca është në fazën e zbatimit të Reformës në Drejtësi, dhe se nesër Komisioni i Ligjeve hap procedurat për KLP dhe KLGJ, duke ftuar opozitën t'i bashkohet procesit për zbatimin e kësaj reforme të rëndësishme. "Jemi në fazën e zbatimit të Reformës në Drejtësi. Politika është shprehur me votë për këtë reformë. Ne do të ecim përpara tashmë. Ndryshimet u miratuan në 21-22 korrik. Palët politike, të gjitha, e shprehën atëherë vullnetin. Ftoj opozitën të ulet në komision për zbatimin e Reformës në Drejtësi, nesër Komisioni i Ligjeve hap procedurat për KLP dhe KLGJ", shtoi deputeti. Kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, tha se do të tentohet të arrihet një konsensus me opozitën për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për disa ndryshime në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese u botua në fletoren zyrtare vetëm në 26 dhjetor 2017, pavarësisht se vendimi u mor në prill 2017. Pasi botohet në fletoren zyrtare, atëherë Këshilli i Legjislacionit në Kuvend i merr në shqyrtim ato. Për vendimin e botuar në maj, Kuvendi në atë kohë ishte shpërndarë. Duhen 84 vota. Opozita të vijë e të japë mbështetjen për t'i adresuar dhe për t'i votuar menjëherë. Do tentojmë sigurisht. Edhe opozita e ka detyrim zbatimin e vendimet e Gjykatës Kushtetuese", tha Manja.

Dokumenti i PS-së, pakti i 18 majit ka rënë që në nëntor

Kreu i grupit të PS në kërkesën e 14 nëntorit për shkarkimin e Klement Zgurit deklaroi marrëveshjen të prishur

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Në seancën e 30 nëntorit të vitit kaluar, kryeministri Edi Rama ftoi kryetarin e opozitës Lulzim Basha në dialog, në një kohë kur Partia Socialiste kishte deklaruar të përfunduar që në 14 nëntor marrëveshjen politike Rama-Basha të 18 Majit. Shqiptarja.com zbardh një dokument, që mban firmën e kryetarit të grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili e deklaron të përfunduar paktin politik Rama-Basha, i cili mundësoi futjen e PD në zgjedhje, në këmbim të ndarjes së pushtetit. Dokumenti mban datën 14.11.2017, me anë të të cilit Partia Socialiste kërkon shkarkimin e kryetarit të KQZ, Klement Zguri. Emërimi i Zgurit, me propozim të PD-PR, ishte pikërisht produkt i marrëveshjes Rama-Basha. Duke argumentuar se pse duhet të shkarkohet Zguri, ndër të tjera Balla shkruan se marrëveshja politike në bazë të së cilës u zgjodh Zguri në krye të KQZ, tashmë ka përfunduar. Në dokument thuhet gjithashtu se marrëveshja Ram-Basha u zbatua duke anashkaluar ligjin. Në këtë kuadër, tërheqja e kryeministrit Edi Rama në 30 nëntor nga shkarkimi i Zgurit dhe ftesa për ta zgjidhur këtë çështje me dialog, duket disi kontradiktore me kërkesën dhe argumentimin e kreut të grupit parlamentar socialist. Nga ana tjetër, Basha deklaroi prishjen e marrëveshjes menjëherë pasi humbi zgjedhjet. "Kujtojmë që z. Zguri nuk u zgjodh në respekt të Kodit Zgjedhor, por të një marrëveshjeje politike, e cila sot konsiderohet e përfunduar. Z. Klement Zguri është zgjedhur kryetar i KQZ me vendimin nr. 78/2017 të Kuvendit, në kuadër të marrëveshjes politike pozitë-opozitë të majit 2017. Ai është zgjedhur pa konkurim, si kandidat i vetëm i ofruar nga opozita, me synimin e shpallur për të ofruar sa më shumë garanci për këtë të fundit, me qëllim sigurimin e një procesi zgjedhor gjithëpërfshirës. Sipas Raportit të OSBE-ODIHR për zgjedhjet 2017: Marrëveshja siguroi pjesëmarrjen e PD-së dhe të aleatëve të saj në zgjedhje dhe përcaktoi që PD-ja do të merrte disa poste. Si pjesë e marrëveshjes politike, Kuvendi zëvendësoi me 22 maj kryetarin e KQZ-së 35 ditë para ditës së zgjedhjeve me një anëtar tjetër të KQZ-së, përfaqësues i opozitës. duke anashkaluar procedurën e parashikuar ligjore", thuhet në kërkesë.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTË
Tiranë, më 14.11.2017
KËRKESË
"Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve z.Klement Zguri, për shkelje të rëndë të ligjit"
Kodi Zgjedhor, në nenin 18 të tij parashikon ndërprerjen parakohe të mandatit të anëtarit/kryetarit të KQZ, por kujtojmë që z.Zguri nuk u zgjodh në respekt të Kodit Zgjedhor, por të një marrëveshjeje politike, e cila sot konsiderohet e përfunduar.
Nga ana tjetër, ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 16, pika 4 të tij parashikon se:
"Dispozitat e këtij ligji janë të barasvlershme me dispozitat e Kodit Zgjedhor ... . Në rast konflikti midis normave, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi."
Po në këtë ligj, sipas nenit 9:
"Çdo organ shtetëror apo person juridik, publik apo privat, ka detyrimin që të bashkëpunojë me organet e ngarkuara nga ky ligj, për verifikimin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave të deklaruara prej shtetasve, sipas këtij ligji. Mosbashkëpunimi apo refuzimi për të bashkë-punuar, pengesa, vonesa apo keqdrejtimi në procesin e verifikimit përbën vepër penale, në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal."
Në këtë pikë, tashmë që mosveprimi i qëllimshëm apo nga paaftësia e z.Zguri, me pasojë pengimin e mbledhjes së KQZ "Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorisë së përgjithshme për funksionarin publik z.Agron Fasllí Kapllanaj, Kryetar i [illegible] Magjistratër, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit [illegible]

Balla
"Kujtojmë që z. Zguri nuk u zgjodh në respekt të Kodit Zgjedhor, por të një marrëveshjeje politike, e cila sot konsiderohet e përfunduar".

Rama
"Pranoj propozimin që të mos futet në kalendarin e Kuvendit kërkesa, dialog me opozitën për të zgjidhur ngërçin. Nuk kemi se çfarë diskutojmë më, nuk është sot për të debatuar".

THIRRJA PËR DIALOG

Në seancën e 30 nëntorit, kryeministri Edi Rama u tërhoq nga nisma për shkarkimin e kreut të KQZ, Klement Zguri. Tërheqja erdhi pas kërkesave të vazhdueshme të Lulzim Basha dhe kreut të PR, Fatmir Mediut. "Pranoj propozimin që të mos futet në kalendarin e Kuvendit kërkesa, dialog me opozitën për të zgjidhur ngërçin. Nuk kemi se çfarë diskutojmë më, nuk është sot për të debatuar" deklaroi Rama.

BASHA PËR MARRËVESHJEN

Në seancën e parë të Kuvendit të ri që doli nga zgjedhjet e 25 qershorit, kryetari i opozitës Lulzim Basha u shpreh se marrëveshja e 18 majit kishte përfunduar, sipas tij, me vjedhjen e zgjedhjeve. "Thelbi i marrëveshjes së 18 majit ishin zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Ndaj dhe zgjedhjet e 25 qershorit shënuan edhe vdekjen e kësaj marrëveshjeje. Zgjedhjet rikonfirmuan problemin numër 1 të Shqipërisë: vjedhjen dhe tjetërsimin e vullnetit të Shqiptarëve për hir të pushtetit personal dhe privat të Edi Ramës", ka pohuar Basha.

Akuza

Vasili: Qeveria po prostituon me Komisionin e Ligjeve



Kryetari i grupit të LSI, Petrit Vasili vijon akuzat e forta në drejtim të qeverisë. Ai thotë se Komisioni i Ligjve është si ISIS-i kundër Kushtetutës. Vasili shprehet se qeveria tani po prostituon me komisionin e ligjeve, ndërsa për Reformën në Drejtësi thekson se ka vdekur. "Komisioni i (anti-)ligjeve, si ISIS-i kundër Kushtetutës. Kushtetutën e shqeu kryeministri në 18 dhjetor kur zgjodhi prokuroren me 69 vota të Rilindjes. Tani po prostituojnë me këtë komisionin e (anti)ligjeve që t'i vënë flakën përfundimisht. Vetëm me vota të Rilindjes dhe me asgjësimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit nga kryeministri Reforma në Drejtësi ka vdekur", deklaron ai. Sipas Vasilit, Rama ka përbuzur Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, duke iu referuar vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, për të përmbysur listën e ONM me kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. "Kryeministri shkatërroi përfundimisht reformën në drejtësi duke asgjësuar edhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). ONM ishte garancia ndërkombëtare e kushtetuese e reformës në drejtësi. ONM ka dhënë opinion negativ për disa kandidate të shoqërisë civile, por mëkëmbësi i kryeministrit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, i përbuz, nuk pyet fare dhe i konsideron normal. Edi Rama e përzuri përfundimisht edhe monitorimin ndërkombëtar nga reforma ne drejtësi. BE dhe SHBA garantuan shqiptaret së ONM do të ishte syri i tyre në reformën në drejtësi ndaj i besuam dhe e vumë në Kushtetutë. ONM u asgjësua nga kryeministri me qëllimin e vetëm qe ai ka: Kapjen e drejtësisë. Pra BE dhe SHBA nuk kanë më sy në zbatimin e paanshëm të reformës në drejtësi. Kujt t'i besojmë tani?", shkruan Vasili.



Topalli: Rama-Basha po qeverisin sipas paktit të 18 majit

"Lulzim Basha është bërë ortak i oligarkëve, marrëveshja e 18 Majit ishte për 14 milionë eurot e pallatit të vjehrrit"

ERNETA SHEVROJA
TIRANE

Ish-kryetarja e Parlamentit, Jozefina Topalli, në një intervistë ekskluzive në Report Tv, komenton zhvillimet në kampin opozitar, ndërsa zbulon edhe projektet e saj. Topalli, një nga figurat kryesore të së djathtës, thotë se vendi është pa qeveri dhe opozitë, ndërsa sipas saj Basha dhe Rama, vijojnë bashkëpunimin mes tyre, në bazë të marrëveshjes së 18 majit. Topalli e quan Bashën ortak të oligarkëve, ku sipas saj po proteston për të negociuar një tjetër marrëveshje. Topalli aludon se, pakti i 18 majit ishte për 14 milionë eurot e pallatit të vjehrrit dhe për disa kulla të tjera. Në intervistë, Topalli flet edhe për marrëdhëniet e saj me ish-kryeministrin, Sali Berisha, duke theksuar se raportet e saj me liderin historik të së djathtës i ka njësoj si më parë.

-Duket se ka një përsëritje të skenarit të kaluar, pra kemi kërkesën e opozitës për largimin e Ramës dhe krijimin e një qeverie të re që Basha e quan anti-mafia. Si i sheh këto zhvillime?

Ajo që thoni në fakt shumë herrë më kalon në mëndje sepse nga retorika që përdoret nga Lulzim Basha, më kujton çadrën, të njëjtën retorikë, ne dorëzojmë Edi Ramën dhe do krijojmë një qeveri teknike dhe kësaj radhe kërkon një qeveri anti mafia. Kjo është fasada, pyetja është se në çfarë situate është Shqipëria. Mendoj se është një ndër momentet më të rënda gjatë këtyre 30 viteve. Është rasti unik kur vendi ynë nuk ka as qeverisje dhe as opozitë. Nuk ka qeverisje sepse këtu nuk qeveriset për qytetarët, sepse 30 % të tyre nuk kanë mundësi të plotësojnë as nevojat më minimale të furnizimit me ushqime që është një alarm. 39 % të tyre nuk janë në gjendje të paguajnë faturat e dritave dhe më shumë se 40 % nuk arrijnë të ngrohin shtëpinë. I bie që të jetojnë në një varfëri ekstreme që faktohet nga raportet e bankës botërore dhe raportet e tjera, kjo për sa i takon ekonomisë. për sa i takon sigurisë jemi një vend i cili është i mbushur me hashash dhe një vend i cili mbështetet tek krimi dhe oligarkët ose më shumë sesa kaq mund të them që janë ato që vendosin edhe mbi vetë kryeministrin. Rreshtova tre, katër arsye thelbësore por s'janë vetëm këto pse vendi është pa qeverisje, pse vendi është opozitë sepse në asnjë vend të botës nuk mund të kishte ndodhur pas skandalit me Saimir Tahirin që qeveria të qëndrojë në këmbë.

-Çfarë mund të kishte bërë Opozita në këtë rast sepse po përsërisje edhe disa deklarata të Bashës? Fakti që ju po e përmendni, gjendja ekonomike e ka theksuar vetë Lulzim Basha. Çfarë roli mund të ketë Opozita në këto pika që përmendët ju dhe në rrëzimin e qeverisë?

Nga momenti që vendi nuk ka opozitë, do të thotë që qeveria kontrollon lidershipin e opozitës, pra nga njëra anë gjatë kësaj periudhe kemi parë të gjithë se Lulzim Basha është bërë ortak i oligarkëve. Mjafton të kujtojmë pjesë nga seancat plenare të muajve të kaluar, ku kryeministri i kërkon Lulzim Bashës që të flasë për emrat e oligarkëve dhe ja përmend me emër dhe ky ul kokën dhe nuk guxon që të thotë një fjalë. Në këto kushte kur opozita kontrollohet nga qeveria për shkak të korruptimit dhe arsyeve të tjera të lidershipit të saj, i bie që vendi jonë është në buzë të greminës sepse kështu bie demokracia dhe nuk ekziston më asnjë garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pyetja juaj është e drejtë, si mund të ndodhi një skandal si i rastit të ministrit të brendshëm dhe qeveria mos të rrëzohet. Kjo ndodh vetëm në rastet kur vendi nuk ka opozitë sepse ato janë bashkë. Kjo është një gjë që e kam përsëritur prej muajsh që në fakt nuk ka filluar me 18 maj, por që është formalizuar me 18 maj.

Për Bashën

"Nga momenti që vendi nuk ka opozitë, do të thotë që qeveria kontrollon lidershipin e opozitës, pra nga njëra anë gjatë kësaj periudhe kemi parë të gjithë se Lulzim Basha është bërë ortak i oligarkëve".

-Pra ju mendoni që ajo marrëveshje ende nuk ka përfunduar, kemi edhe një rivendosje të Parlamentit?

Në fakt unë mendoj se nëse marrëveshja e 18 majit ishte 14 milionë eurot të pallatit të Lulzimit apo për kullat apo ku di unë, mendoj se protesta e ardhshme është thirrur si një presion për të ri negociuar 18 majin.

-Meqë dolët te protesta, çfarë pritshmërisë keni ju nga ajo protestë, është paralajmëruar në fakt një valë protestash që do të nisë në 27 janar, çfarë pritshmërisë keni ju nga ato protesta?

Çfarë pritshmërie mund të ketë nga një protestë që kërkon të ri negociojë 18 majin që sipas mediesh ishte për milionat e pallatit dhe të kullave që do të ndërtohen në Tiranë, ndaj dhe thashë që vendi është në buzë të greminës. Përgjigjes tënde i është përgjigjur dje Lulzim Basha në një tv, ku thoshte që nëse nuk doni që të paguani taksën e Lulit, të vjehrrit dhe të kunatit, dua të rrëzoni Edi Ramën. I bie që ai nuk kërkonte paratë e Edi Ramës, por u thotë qytetarëve o paguani paratë, ose më jepni pushtetin se alternativë tjetër nuk ka. Pra vendi është pa opozitë dhe ato janë bashkë, nëse shqiptarët nuk do të ngrihen në protestë për të rrëzuar Lulin, Edin edhe Monën dhe të gjithë këto që kanë pushtetin bashkë me oligarkët që synojnë këto qeveritarë, ky vend edhe për 20 vjet të tjera do sundohet nga Lali Eri, Mona dhe Edvini. Fëmijët që lindin sot, do bëhen 20 vjeç dhe do kenë këto mbi krye dhe ato që janë 20 vjeç do bëhen dhe 50 vjeç dhe do kenë po këto mbi krye.

-Ish-kryeministri ka propozuar djegien e mandateve, a duhet të djegin mandatet deputetët e opozitës ose PD?

Nuk ekziston e djathta në Shqipëri, as PD, ekziston grupi i familjes të Lulzim Bashës dhe të oligarkëve të tyre.

-Ndërkohë që shohim që kemi aksione të përbashkëta të Bashës më zonjën Kryemadhi. A duhet të ketë PD aksione të përbashkëta me LSI?

Kam dëgjuar një prej këtyre që ka zënë karrigen e parlamentit që thotë ne jemi një opozitë e fortë sepse kemi edhe 20 karriget e LSI, pra humbin edhe 20 karrige të tjera këto në zgjedhjet parlamentare, ndihen të fortë se kanë 20 karrige të LSI. Të thuash se është papërgjegjshmëri, nuk di të gjej fjalën, ku kanë pasur nevojë demokratët që të shkojnë në protestë me thirrje të të majtëve, kur? Kjo ndodh vetëm kur nuk ekziston opozita dhe kur ajo është e kontrolluar nga qeveria për ambicie personale, financiare të kryetarit.

Marrëveshja

"Në fakt unë mendoj se nëse marrëveshja e 18 majit ishte 14 mln eurot të pallatit të Lulzimit apo për kullat apo ku di unë, mendoj se protesta e ardhshme është thirrur si një presion për të ri negociuar 18 majin".

-Kalojmë pak te seanca në 18 dhjetorit, kur u zgjodh kryeprokurorja e Arta Markut, si i patë ato veprime brenda asaj seance?

Është mjerim i madh, nuk është parlament, është teatër në të cilin kryeministri dhe kryetari i vetëshpallur i asaj që quan opozitë, ndërkohë që çojnë mesazhe, luajnë teatrin sikur po kundërshtojnë njëri tjetrin. Nuk ka ndodhur kurrë në 30 vite që t'i bllokohet foltorja deputetit nga garda, e pa imagjinueshme. Sa herë që duan të bëjnë teatër, të shkojnë në stadium të hedhin tym, por jo në parlamentin e Shqipërisë. Ishte pamje e shëmtuar.

-Ju keni qenë një nga figurat kryesore të Partisë Demokratike, a po i ndiqni zhvillimet brenda PD?

Nuk ka PD, ka grup të familjes Basha, sigurisht që e ndjek çdo sekondë, 24 orë, çdo gjë që ndodh në teatrin politik të mjerimit të Shqiptarëve dhe të pasurive të tyre.

-Zonja Topalli a do ju shohim ndonjëherë më aktive në PD, pavarësisht pretendimeve që ju keni për atë parti?

Karrigen e kryetarit e kanë vjedhë, në zgjedhjet e 23 korrikut kur ai vetë shpallet kryetarë dhe këtë nuk e thotë me fjalë, po për këtë ka video me zë dhe figurë. Ai që ka shpallur veten kryetarë të PD ka mbushur kutitë dhe ka vjedhur votat në pjesëmarrjen e demokratëve. Kjo është njëra anë, e përsëris se më 18 maj , për ambiciet e tij financiare, ai i ka fal mandatin e dytë Ramës me 23 korrik ai fal mandatin e tretë. Nëse ju thoni se kjo është opozitë, duhet të filloj të pyes vërtetë se çfarë konceptesh kemi për qeverisjen dhe për opozitën. Është i vetmi vend anëtarë i NATO-s që nuk ka as qeverisje as opozitë.

-A keni komunikim me ish kryeministrin Sali Berisha? Është konstatuar se pas largimit tuaj nga parlamenti, ka ndryshuar dhe marrëdhënia juaj me ish kryeministrin?

Është njëlloj siç ka qenë në 20 vite.

-Flisni shpesh për projekte, për PD, ku duhet të ishte?

Për Lulin kam folur shumë gjatë në shumë vite dhe tani flas në televizor, nuk flas më në zyra.

-Në qoftë se do të kishit një ftesë nga Lulzim Basha për tu bërë pjesë e PD sërish, do pranonit?

Lulzim Basha nuk është Partia Demokratike, ka vjedhur karrigen e kryetarit dhe këtë e keni me video, me zë dhe me figurë përmes dhunimit të votave, ai është bedeli i qeverisë Rama, dhe unë nuk mund të besoj të shkoj për të protestuar kundër qeverisë Rama, nga një thirrje të ardhur nga bedeli i Edi Ramës.

SHPALLJE ANKANDI

Përmbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e Parë për pasurinë "truall+banese dy katëshe,", me sipërfaqe 200 m2, me nr. Pasurie 12/86, vol.7,fq.171, Z.K. 8531, e ndodhur në Lagjen 1 Maji, Fier.

Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 9,600,000(nëntë milion e gjashtëqind mijë) lek ose 72,000 (shtatëdhjet e dy mijë) euro.

Ankandi zhvillohet me **datë 25.01.2018, ora 16:00** në ambientet e Zyrës së permbaruese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë.

Rama: Skënderbeut është forcë emancipimi dhe evropianizimi

Do mbillen 550 ullinj në Petrelë nga arbëreshët e Italisë. Zbardhet axhenda e aktiviteteve

Rama

"Ne po e mbajmë gjallë figurën e Skënderbeut, jo me imazhe, por doket tona. Të gjithë së bashku ne do i presim të gjithë arbëreshët. Skënderbeu ka qenë forcë emancipimi dhe evropianizimi".



Ullinjtë

Arbëreshët e ardhur nga jugu i Italisë do të mbjellin nesër 550 ullinj rreth kalasë së Petrelës, si simbol i paqes dhe i harmonisë mes njerëzve, një trashëgimi e lënë që nga koha e Skënderbeut.

Në Pallatin e Kongreseve u organizua një aktivitet nga qeveria me rastin e 17 janarit, që shënon 550-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut. Gjatë fjalës së tij, kryeministri Edi Rama u shpreh se heroi ynë kombëtar ka qenë forcë emancipimi dhe evropianizimi. "Skënderbeu cilësohej si një zotëri në një vend të vogël dhe të varfër, por që kërkoi të mbahej me këmbët e veta. Sot 150 arbëreshë kanë ardhur për të kujtuar figurën më të lartë të historisë. Shumë prej tyre vijnë për herë të parë në Shqipëri, pasi po mundohemi që të ngjisim copëzat. Ne po e mbajmë gjallë figurën e Skënderbeut, jo me imazhe, por doket tona. Të gjithë së bashku ne do i presim të gjithë arbëreshët. Skënderbeu ka qenë forcë emancipimi dhe evropianizimi. Për herë të parë përkujtimi i figurës së Skënderbeut, është si një ekspozitë për të zbuluar fakte dhe në njohje të panjohshme të figurës së tij. Në këtë hapësirë, në këto ditë, ndoshta nuk mund të ekspozohet gjithçka, unë them një shprehje latine 'ejani dhe shihni", tha Rama. Kryeministri njoftoi se në nëntor do të zhvillohet në Tiranë Samiti i Diasporës. "Në samitin e diasporës, në nëntor, do të sjellë të gjithë bijat dhe bijtë e Skënderbeut kudo që janë", deklaroi ai. Aktiviteti "Tre ditët e Yllit të Mëngjesit" është një kremtim i 550-vjetorit të kalimit në amëshim të Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Një hapësirë në Pallatin e Kongreseve është kthyer në një pikëtakim surprizë për të gjithë ata që do ta vizitojnë gjatë këtyre tre ditëve.

550 ULLINJ NGA ARBËRESHËT

Në kuadër të organizimeve për vitin jubilar të Skënderbeut, Tiranën po e vizitojnë përfaqësues të komunitetit arbëresh në Itali, të cilët kanë ruajtur të gjallë në këngë figurën e heroit tonë kombëtar. Së bashku me Kryetarin e Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj, arbëreshët e ardhur nga jugu i Italisë do të mbjellin nesër 550 ullinj rreth kalasë së Petrelës, si simbol i paqes dhe i harmonisë mes njerëzve, një trashëgimi e lënë që nga koha e Skënderbeut.

AKTIVITETET NE TIRANE

Ditën e sotme, figura të larta shtetërore nga Shqipëria, Kosova dhe trevat e tjera shqiptare do të marrin pjesë në ceremoninë e posaçme që do të organizohet në përkujtim të figurës dhe veprës së Heroit tonë. Ceremonia do të nisë në orën 17.30 me një ecje nga sheshi "Nënë Tereza" drejt sheshit "Skënderbej" dhe në orën 18:00 do të vendosen kurora nga personalitetet e shtetit dhe komunitetit arbëresh në monumentin e Skënderbeut, pikërisht në sheshin që mban emrin e tij, i cili në mënyrë simbolike, për gurët me të cilët është ndërtuar dhe pemët me të cilat është gjelbëruar, përfaqëson të gjitha trojet shqipfolëse. Kryetari i Bashkisë së Tiranës do të mbajë një fjalë përshëndetëse për qytetarët dhe për të ftuarit e nderit, ndërsa në orën 19.00 do të mbahet eventi i madh përmbyllës në përkujtim të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut në sallën e madhe të Qendrës kulturore ortodokse, shoqëruar nga një koncert me repertorin arbëresh luajtur nga grupet e ardhur nga Italia.

REPORT TV / RUBRIKA TË REJA, RISI DHE SURPRIZA NËN DREJTIMIN E ERJONA RUSI DHE ALBAN MUSA

"Rreze Dielli", vjen formati i ri i emisionit të mëngjesit

Nga mëngjesi i ditës së sotme, paraditet tuaja do të shoqërohen me formatin e ri të emisionit "Rreze dielli" në Report TV. Për çdo ditë nga e hëna në të premte, në orën 9:00 – 11: 00 Erjona Rusi dhe Alban Musa do të bëhen miqtë tuaj të përditshëm.

Bashkë me Zonjën Tefta në kuzhinë, formati i ri i Rreze Dielli premton risi dhe surpriza. Me këtë slogan duke filluar nga dita e sotme emisioni i paradites ne Report Tv, ndryshon forme e përmbajtje për të qenë më pranë shikuesve të shumtë që i besojnë këto orë të para të ditës ekranit të Report TV. Në këtë sezon televiziv "Rreze Dielli" vjen me ndryshime në rubrika, skenografi dhe prezantues. Nga dita e sotme shoqëruesit tuaj të paradites do të jenë Erjona Rusi dhe Alban Musa, që i janë bashkuar së fundmi familjes së "Report Tv". Nuk do mungojë si gjithmone zonja Tefta, e cila me recetat e saj tashmë është bërë prej vitesh një guidë kulinarie për amvisat shqiptare.

Nuk mbetet gjë tjetër vetëm të jemi të gjithë sy e veshë nesër në orën 9 për të ndjekur "Rreze Dielli", bashkë me Erjonën, Albanin dhe Teftën të cilët do t'ju shoqërojnë nga ora 9.00 deri në 11.00 çdo ditë nga e hëna në të premte, në "Report Tv".



VIDEO/ "RREZE DIELLI", VJEN FORMATI I RI I EMISIONIT TË MËNGJESIT

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

NJOFTIM

BSA Bailiff Services Albania

Shoqeria Permbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me adrese Bulevardi "Gjergj Fishta" Pallati Gora, Kulla nr.2, Kati 2, Apartamenti 9, Tirane, ne zbatim te dispozitave te Kodit te Procedures Civile, njofton se do te kryeje procedurat per shitjen ne ankand te dyte te pasurive te paluajtshme, **me date 08.02.2018, ora 16:00,** si me poshte:

- **"Truall + Ndertese"** nr. pasurie 6/43, ZK. 8541 me sip. totale trualli 187.5 m2 dhe sip.ndertese 375 m2, e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 140 date 11.11.2008 e ndodhur ne Gjirokaster, e regjistruar prane ZVRPP Gjirokaster ne pronesi te Shoqeria "Flladi" sh.p.k **me vlerë 217,840 Euro.**

Per informacione mund te kontaktoni nr Tel. 044 500 278 ose adresen e-mail: entonmuhametaj@gmail.com

NJOFTIM

BSA Bailiff Services Albania

Shoqeria Permbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me adrese Bulevardi "Gjergj Fishta" Pallati Gora, Kulla nr.2, Kati 2, Apartamenti 9, Tirane, ne zbatim te dispozitave te Kodit te Procedures Civile, njofton se do te kryeje procedurat per shitjen ne ankand te dyte te pasurive te paluajtshme, **me date 07.02.2018, ora 16:30,** si me poshte:

- **"Truall + Ndertese"** me nr.pasurie 231/7, vol. 6, fq. 183, ZK. 2605 me sip. trualli 300 m2 dhe sip. ndertese 100 m2, e ndodhur ne Marqinet, Tirane, e regjistruar prane ZVRPP Tirane, ne pronesi te bashkepronareve Petrit Gjoka, Hajrie Gjoka, Vjollca Gjoka, Avdi Gjoka dhe Florina Gjoka **me vlere 8,842,708 Leke.**

Per informacione mund te kontaktoni nr Tel. 044 500 278 ose adresen e-mail: entonmuhametaj@gmail.com

NJOFTIM

BSA Bailiff Services Albania

Shoqeria Permbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me adrese Bulevardi "Gjergj Fishta" Pallati Gora, Kulla nr.2, Kati 2, Apartamenti 9, Tirane, ne zbatim te dispozitave te Kodit te Procedures Civile, njofton se do te kryeje procedurat per shitjen ne ankand te dyte te pasurive te paluajtshme, **me date 07.02.2018, ora 16:00,** si me poshte:

- **"Arë + Truall"** nr. pasurie 422/62, vol. 11, fq. 92, ZK. 1665 me sip.totale 1955 m2, nga të cilat 300 m2 truall dhe 100 m2 ndërtesë e ndodhur në Fushë Krujë, e regjistruar pranë ZVRPP Krujë, në pronësi të Arben Dema, **me vlerë 40,960 Euro.**

Per informacione mund te kontaktoni nr Tel. 044 500 278 ose adresen e-mail: entonmuhametaj@gmail.com

Dialogu i grabitësit me arkëtaren "...mi jep lekët ose të vrava..."

Autori harroi çadrën në ambjentet e hipotekës. Arrestohet roja i bankës



Grabitësi në mometin brenda në bank



Roja
Ai ka përdorur një kapele në kokë ndërsa në brez ka pasur armën e zjarrit tip pistoletë. Mësohet se në momentin kur ka hyrë në ambientet e Hipotekës, fillimisht ka neutralizuar rojen e institucionit.

Idetifikimi
Policia e Tiranës vijon punën për identifikimin e autorit të kësaj ngjarje i cili terrorizoi në mes të ditës Tiranën duke grabitur bankën në ambientet e një institucioni publik krejtësisht i pashqetësuar.

Gajtë 24 orëve veprime hetimore policia e Tiranës ka mundur të arrestojë një person për grabitjen e filialit të bankës brenda ambienteve të Hipotekës në Tiranë dhe një tjetër po hetohet i lirë. Sipas policisë i pragosuri është punonjësi i sigurisë, i cili në momentin e grabitjes nuk ka reaguar fare. Autori i ngjarjes, një i ri rreth moshës 25-vjeç, ka shfrytëzuar disa çadra përgjatë trotuarit që të çon te Hipoteka e Tiranës, për të mos rënë në sy. Ai ka përdorur një kapele në kokë ndërsa në brez ka pasur armën e zjarrit tip pistoletë. Mësohet se në momentin kur ka hyrë në ambientet e Hipotekës, fillimisht ka neutralizuar rojen e institucionit, ndërsa më pas i është drejtuar sportelit të bankës private, ku i ka drejtuar armën arkëtares.

"...MI JEP LEKËT OSE TË VRAS..."

Punonjësja e bankës, në kushte terrori, pasi është kanosur nga autori i cili i ka thënë "...më jep lekët ose të vras..." dhe në një moment me qytën e armës ka qëlluar xhamin e bankës i cili ka pësuar plasaritje, ka hapur kasafortën dhe kanë nxjerrë prej aty rreth 300 mijë lekë të reja duke ia dhënë autorit. Më pas grabitësi, me qesen e parave në dorë, është larguar përmes një blloku pallatesh ku edhe është fiksuar nga disa kamera sigurie. Në lagjen "Don Bosko", grabitësi është ndeshur me një punonjës policie, të cilit i ka drejtuar pistoletën dhe i ka kërkuar të mos e ndjekë pasi pëndryshe do ta qëllonte. Policia e Tiranës vijon punën për identifikimin e autorit të kësaj ngjarje i cili terrorizoi në mes të ditës Tiranën duke grabitur bankën në ambientet e një institucioni publik krejtësisht i pashqetësuar.

AUTORI HARROI ÇADRËN BRENDA HIPOTEKËS

Burime nga policia thanë se kanë rënë në gjurmët e autorit të grabitjes. Një provë që e ka tradhtuar grabitësin ka qenë çadra e harruar brenda ambienteve të Hipotekës. Ai është futur në Hipotekë me çadër në dorë dhe kur ka nxjerrë armën e ka hedhur atë. Por kur është larguar, ka harruar ta marrë me vete. Mendohet se në çadër ndodhen prova të mjaftueshme si gjurmët e gishtave, për të identifikuar autorin, pasi ai nuk ka përdorur doreza. Sipas dëshmitarëve, grabitësi ishte me trup të dobët, rreth 170 cm i gjatë dhe i moshës 25-27 vjeç. Policia mbërriti në ambientet e Hipotekës rreth 5 minuta pas ngjarjes. Në momentin kur ka hyrë në ambientet e Hipotekës, fillimisht ka neutralizuar rojen e institucionit, ndërsa më pas i është drejtuar sportelit të bankës private ku u ka drejtuar armën arkëtareve. Punonjësja e bankës, në kushte terrori, pasi është kanosur nga autori i cili i ka thënë "më jep lekët ose të vras" dhe në një moment me qytën e armës ka qëlluar xhamin e bankës i cili ka pësuar plasaritje, ka hapur kasafortën dhe kanë nxjerrë prej aty rreth 300 mijë lekë të reja duke ia dhënë autorit.

GJYKATA NXJER TË LIGJSHËM SHKARKIMIN

Paditi Markun, Administrativja rrëzon prokuroren Rovena Gashi



Rovena Gashi

Gjykata Administrative ka rrëzuar padinë e Rovena Gashit kundër kryeprokurores Arta Marku. Prokurorja Gashi paditi Markun, pasi kjo e fundit e shkarkoi nga detyra e drejtores së njësisë së dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Pas vendimit të gjykatës, avokati i prokurores Gashi foli për media, duke deklaruar se do të ankimojë vendimin e shkallës së parë. Avokati Çlirim Gjata tha se Gashi është shkarkuar pa asnjë motivacion, duke shtuar se as në kohë të diktatorit Enver Hoxha nuk ka pasur shkarkime të tilla. Sipas tij, as një pastrues nuk mund të shkarkojë kryeprokurorja pa motivacion dhe jo më një drejtoreshë. "Me kompetencë të plotë ligjore nuk kam parë ndonjëherë akt administrativ më të paligjshëm dhe më antikompetent. Është shkarkuar një drejtore e Drejtorisë pa asnjë motivacion. Ka rrezik që as në kohën e Enver Hoxhës të keni shkarkim detyre pa motivacion. As një pastrues nuk mund të shkarkojë kryeprokurorja pa motivacion jo më një drejtoreshë Drejtorie"-tha Gjata. Vendimi mund të apelohet brenda 5 ditëve, ndërsa më 31 janar, gjykata pritet të shqyrtojë në themel padinë e Gashit ndaj kryeprokurores. Ndërkohë, kryeprokurorja Marku është paditur dhe nga bashkëshorti i Rovena Gashit, ish-kryeprokurori i Elbasanit, Dritan Gina, pas shkarkimit nga detyra. Në padinë e depozituar te Krimet e Rënda, Gina kërkoi pezullimin nga detyra të Kryeprokurores Arta Marku dhe urdhërimin e kryerjes së ekspertizës psikiatriko-ligjore.

BORSH

Arrestohet në kufi një 51 vjeçar i dënuar me 10 vite burg

Policia kufitare Borsh ka arrestuar pasditen e djeshme një 51 vjeçar të dënuar me 10 vite burg për veprën penale "Mashtrim". Artan Muça 51 vjeç banues në Tiranë ishte në kërkim nga Policia e Shtetit ku është kapur dhe ndaluar në fshatin Lukovë, Himarë nga Strukturat Policore të Stacionit të Policisë Kufitare Borsh në bashkëpunim me Seksionin e Hetimit. 51-vjeçari ka rezultuar i shpallur në kërkim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e ka dënuar me 10 vite burg për veprën penale "Mashtrim". Muça do të shoqërohet pranë ambienteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për veprime të mëtejshme.

FIER

Arrestohet 33-vjeçari me doza kokaine dhe armë zjarri

Policia e Fierit ka arrestuar për shitje të lëndëve narkotike 33 vjeçarin Mario Beqiri banues në Lushnje. Gjatë operacionit të antidrogës të koduar "Ehite" është sekuestruar një dozë kokaine në flagrancë, ndërsa pas kotrolit të ushtruar në banesën e Beqirit u gjet një sasi tjetër rreth 24 gramë lëndë narkotike e dyshuar kokainë, një peshore elektronike e cila shërbente për ndarjen e lëndës në doza, një armë zjarri pistolet e markës ECOL Special, një krehër, tre fishekë, një thikë, 110 Euro, 400 dollarë si edhe automjeti i markës "Audi A3". Materialet proceduriale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje i armëve dhe municionit luftarak" dhe "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje i armëve të ftohta".

BULQIZË

Shpërthim eksplozivi raportohen dëme të vogla

Një shpërthim më lëndë plasëse ka ndodhur, ditën e djeshme në datën 15 janar 2018 rreth orës 23:10, në vendin e quajtur "Pishat". Një sasi e vogël lënde plasëse i është vendosur një automjeti tip "Land Rover", në pronësi të shtetasit A.Sh, 41 vjeç, banues në Fushë-Bulqizë. Sipas raportimeve të shtetasit që kishte në pronësi automjetin, ky automjet ka qenë i parkuar prej disa ditësh në anë të rrugës, pasi nuk ishte në gjendje të rregullt teknike. Sipas raportimeve nga shpërthimi i mjetit nuk ka pasur të dëmtuar por vetëm dëme të vogla materiale të mjetit. Pritet të vijnë ekspertët për të përcaktuar llojin e lëndës plasëse.

STUDIO PËRMBARIMORE
"DE NOVO"

NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 3 PËR :

"Apartament" me sip.71.6 m², me Nr. pasurie 2/9+2-19, Z.k.8260, Volumi 4, faqe 249 me adresë Rr."Irfan Tomini" Tiranë.Kjo pasuri është hipotekuar në favor të BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **21 168 (njëzet e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) EURO.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **18.01.2018 Ora 16:00** pranë Studios Përmbarimore"DE NOVO" sh.p.k (ish Speed Solution sh.p.k), me Adresë : Rruga "Frederik Shiroka", Pallatet"Gora", Kulla 3, Shkalla 1, Kati 2, Nr.1, Tirane.

PER ÇDO INFORMACION MUND TË NA KONTAKTONI
CEL . 0693041355, EMAIL : INFO@DENOVO.AL

Dëshmia e vëllait të të zhdukurit: Si më vranë babain e xhaxhanë

Albert Lleshi rrëfen se nga hasmëria në Angli dyshon se i vëllai është rrëmbyer dhe vrarë

ELTON QYNO
TIRANE

Një histori vrasjesh që ka nisur nga Anglia mes dy familjeve shqiptare, i ka hapur serinë e vrasjeve hakmarëse në Shqipëri, ku brenda një kohe të shkurtër dy vëllezër janë vrarë dhe një person i tretë, mendohet se është zhdukur pa lënë gjurmë. Artan Lleshi prej datës së 5 nëntorit 2017 nuk ka asnjë të dhënë, ndërkohë dyshimet flasin se ai është zhdukur nga hasmit e tij, duke u nxjerrë në pritë nga shoku i vet Mario Murati. "Shqiptarja.com" zbardh të plotë dëshminë e vëllait të personit të zhdukur i cili tregon me detaje momentin e zhdukjes dhe hasmërinë e nisur në Angli, prej të cilës ai ka humbur xhaxhain dhe babain e tij. Murati është arrestuar nga policia në aeroportin e Rinasit. Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi Mario (Altin) Murati ka qenë personi i fundit që ka pasur kontakt me të zhdukurin Artan Lleshi në datën 5 nëntor 2017 në Institutin Bujqësor dhe po ashtu nga hetimi i deritanishëm i këtij procedimi penal nga deklarimet e shtetasve Dikensë Rapushaj, shok i shtetasit Artan Lleshi i cili deklaron se personi i fundit me të cilin ka qenë shtetasi Artan Lleshi dhe më pas me të cilin është larguar, ka qenë shtetasi Mario (Altin) Murati si dhe deklarimeve të tjera të familjarëve të cilët kanë dyshime se shtetasi Mario Lleshi u ka zhdukur vëllanë e tyre duke bashkëpunuar me anëtarët e fisin e shtetasit Ali Hoxha me banim në Mamurras Kurbin. Gjithashtu Artan Lleshi rezulton të ketë lidhje fisnore me hasmin shtetasin Ali Hoxha dhe konkretisht ka djemtë e tezes së tij shtetases Vashe Kolaveri, janë kushërinj në familjen e Ali Hoxhës. I ndaluari Altin ose Mario ka fshehur takimet që ka pasur me këtë shtetas si dhe mohon faktin se e ka marrë me automjetin e tij shtetasin Artan Lleshi në momentin e fundit të zhdukjes së tij, si dhe duke mos treguar vendndodhjen.

DËSHMIA E ALBERT LLESHIT

"...vëllai im Artan Lleshi është larguar nga shtëpia që në datën 5 nëntor 2017, rreth orës 1730 (veshur me tuta sportive, ngjyrë gri, me mbishkrimin apo stampën NIKE, bluzë sportive ngjyrë të zezë me kapuç po me mbishkrimin NIKE, një palë këpucë të zeza, ka pasur telefonin me vete Samsung tip i thjeshtë me numër telefoni 069XXXXX). Ditën që është larguar e ka parë vëllanë Artanin në një lokal bar kafe, në lagjen ku banojnë, me një shok të tij nga Vlora të quajtur Diku, me numër telefoni 067XXXX, i ka përshëndetur dhe është larguar pa i takuar. Në orën 19:00, unë i kam thënë mamasë, Zenës që ta merrte në telefon vëllanë, por mamaja më tha se "Artani i kishte lënë porosi që të mos i binte telefonit pasi ishte me një shok dhe do vinte". Të nesërmen, në datën 6 nëntor 2017, në mëngjes, kanë vënë re se Artani nuk kishte ardhur në shtëpi dhe rreth orës 07:00 mamaja ime i ka rënë telefonit të vëllait por ai ishte i fikur. Gjatë kësaj dite, me telefonin e mamasë me numër 0698XXXX, i kanë rënë telefonit të Artanit me numër 069XXXX, por gjithmonë ai dilte i fikur. Në këto kushte kemi marrë në telefon shokun e Artanit nga Vlora, ku Dikun (Dikens Rapushaj) e kemi pyetur se ku ishte Artani dhe mësojmë se një ditë më parë, pasi kishin pirë kafe në lokalin sipër marketit të Petrit Kukës, kishin dalë të dy dhe kishin shkuar në rrethrrotullimin e Kamzës, pasi Artani donte të takonte Altin Muratin, shok i tij, me numër telefoni 0698XXXX, të cilin na e dha Diku. Ata kishin shkuar te rrethrrotullimi i Kamzës dhe aty Artani ka shkuar te makina e Altin Muratit, ku Altini ishte vetë i dytë dhe të tre, Altin Murati, shoku i tij dhe Artan Lleshi janë larguar me makinën e Altin Muratit. Diku na tha se e kishte pritur Artanin, por ai nuk ishte kthyer, ku i kishte rënë disa herë telefonit të Artanit, por edhe në atë kohë telefoni i Artanit ishte i fikur, ku nuk ka ndonjë të dhënë tjetër për vendndodhjen e vëllait Artanit. I kanë rënë edhe telefonit të Altin Muratit me numër 069XXXX, të cilit i bënim telefonatë deri në datën 6 nëntor 2017, rreth orës 11:00, por nuk na përgjigjej në telefon, më pas telefoni rezultonte i fikur, deri më sot. Gjithashtu Alberti deklaron se ne kemi hasmëri me familjen e Ali Hoxha, nga fshati Shtjefën i Matit, pasi djali i xhaxhait tim Arben Lleshi, ka vrarë shtetasin Afrim Hoxha në Angli, ngjarje e ndodhur rreth vitit 2011 apo 2012, ku Afrimi është djali i Ali Hoxhës, ku me sa dimë Ali Hoxha është me banim në Mamurras. Më pas, pas shtatë muajsh nga kjo ngjarje, më është vrarë xhaxhai Xhavit Lleshi në fshatin Rokaj në vendin e quajtur Pujkë tek ura, ndërsa në datën 14 maj 2017, më është vrarë babai im në shtëpitë tona në prag të shtëpisë, në fshatin Rrokaj të Matit, ku si për vrasjen e xhaxhait tim dhe po ashtu për babanë tim nuk dihet se kush është autori. Ne kemi problemet e hasmërisë me këtë familje. Shpjegoj se Arben Lleshi (kushëri me të zhdukurin Artan Lleshi dhe konkretisht djali i xhaxhait të tij) është i dënuar aktualisht nga Gjykata e Krimeve të Rënda në Angli, ku është ekstraduar në Shqipëri dhe vuan dënimin në IEVP-në, në Fushë Krujë, me sa di. Po ashtu shpjegon se nuk kanë pasur kërcënime nga familja e Ali Hoxhës, bile edhe për vrasjen e babait ata nuk e kanë pranuar ta kenë bërë ata, kur janë pyetur nga policia. Po ashtu shpjegon se nuk e dinte nëse Diku nga Vlora ka njohje me shtetasin Altin Murati dhe në lidhje me largimin vëllai i tij Artan Lleshi nuk ka lënë asnjë shënim...".


Artan Lleshi

DËSHMIA E TË ARRESTUARIT

"... për herë të fundit në Shqipëri kam ardhur në datën 19 shtator 2017. Kam ardhur në Rinas nga Vjena, e larguar përsëri për në Gjermani, ku kam ndjekur këtë rrugë në datën 7 nëntor 2017 rreth paradites kam marrë çantën nga shtëpia, nuk ka lajmëruar njeri të shtëpisë se po ikte në Gjermani, ka ndenjur deri në orën 17:00 ku në rrugë kryesore në Bathore ka ndalur një furgon Sharon 6+1 vende, me ngjyrë të errët, targat nuk ia mban mend dhe as shoferin nuk e njihte, por ishte furgon linje për në Kukës. Ka arritur në Kukës në 18:40, ku ka zbritur në qendër të Kukësit ku rrinë taksitë që ikin për në Prizren, ka marrë një taksi autoveturë tip Ford me portobagazh me ngjyrë të zezë, targat nuk ia mban mend, dhe as shoferit nuk ia di emrin, dhe kanë kaluar pikën e kalimit kufitar Morinë në orën 19:00. Në Prizren ka arritur rreth orës 19:30, ku ka paguar 20 (njëzet) Euro e ka zbritur nga kjo taksi, te Terminali i Stacioneve të Autobusit në Prizren. Më pas ka shkuar në këmbë për rreth pesë minuta deri te blloku i hoteleve që ndodhet pesë minuta në këmbë nga stacioni i autobusëve dhe ka shkuar në një hotel tre-katërkatësh më duket se Hotel Hollidei" ose "Hotel Alvida", në një nga këto dy hotele, pasi nuk e mbaj mend mirë, ku jam regjistruar në sportel me kartën time dhe ka qenë ora rreth 20:00. Në këtë hotel ka ndenjur deri të nesërmen në dt. 08.11.2017, në orën 09:00, kam parapaguar për fjetjen rreth 30 Euro, ku në sportel ka qenë një burrë. Më pas ka shkuar përsëri te terminali i autobusëve, dhe i ka hipur direkt një autobusi për në Prishtinë, ku ka qenë ora rreth 09:30 dhe ka paguar për rrugën 5 euro në autobus te fatorino e autobusit. Autobusin nuk e mban mend çfarë ngjyre dhe targe. Ka arritur në Prishtinë rreth orës 11:00, ku ka zbritur në terminalin e autobusëve, kam prerë biletën për në Shkup më sportelin e prerjes së biletave, e cila ka kushtuar 5 euro. Ka pritur autobusin e radhës për rreth 30 minuta. Për në Maqedoni ka kaluar pikën e kalimit kufitar ku është regjistruar, emrin e pikës nuk e di, por fashti i fundit i Kosovës Kaçanik dhe direkt vinte pika e kalimit kufitar. Në Shkup kam arritur rreth orës 14:30 te terminali i autobusëve dhe ka marrë direkt një taksi për në aeroportin e Shkupit, ku nuk ka gjetur avion për në Vjenë është kthyer përsëri te terminali i autobusëve në Shkup dhe ka qëndruar në një hotel të vjetër, ngjitur me terminalin, ku i ndan vetëm rruga kryesore,aty. Është regjistruar në këtë hotel me Kartën e identitetit dhe ka paguar dhjetë euro, të nesërmen, në datën 9 nëntor 2017, rreth orës 08:00 ka dalë nga hoteli, ka pritur pranë terminalit në rrugën Qershia e Vjetër të hapeshin agjencitë e udhëtimit dhe te një agjenci udhëtimi ka prerë biletën e avionit nga Shkupi për Austri transit, dhe më pas në Barcelonë ku jam nisur në orën 12:30 me avion, në Barcelonë pas orës 19:00, në Barcelonë kam ndenjur në një hotel emrin nuk ia di.

Detajet

FSHEHJA
I ndaluari Altin ose Mario ka fshehur takimet që ka pasur me këtë shtetas si dhe mohon faktin se e ka marrë me automjetin e tij shtetasin Artan Lleshi në momentin e fundit të zhdukjes së tij, si dhe duke mos treguar vendndodhjen.

PAS 7 MUAJ
Pas shtatë muajsh nga kjo ngjarje, më është vrarë xhaxhai Xhavit Lleshi në fshatin Rokaj në vendin e quajtur Pujkë tek ura, ndërsa në datën 14maj 2017, më është vrarë babai im në shtëpitë tona në prag të shtëpisë, në fshatin Rrokaj të Matit, ku si për vrasjen e xhaxhait tim dhe po ashtu për babanë tim nuk dihet se kush është autori.

HASMËRIA
Gjithashtu Alberti deklaron se kanë hasmëri me familjen e Ali Hoxha, nga fshati Shtjefën i Matit, pasi djali i xhaxhait tim Arben Lleshi, ka vrarë shtetasin Afrim Hoxha në Angli, ngjarje e ndodhur rreth vitit 2011 apo 2012.

Shoqëria Përmbarimore
"ZIKE" sh.p.k

Shoqëria Përmbarimore "ZIKE" sh.p.k, me adresë: Blv."Gjergj Fishta" Pallatet "Gora" Kulla 2, Kati 2, Ap 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-3, të pasurise të paluajtshme në pronësi të z.Erjon Fejzo Nazeraj si më poshtë:

- **Në datë 31.01.2018 ora 16:45**

-Pasuri nr. 717/2, ZK 3384 lloji i pasurise (truall+ndertese) me sip. 350 m2 (truall), dhe 109 m2 (ndertese) me adrese Shkalle Mavrove, Vlore, me cmimi fillestar eshte 1,461,600 leke.

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e
Tel. 044 500 278 ose adresën e e-mailit: ilirdervishi85@gmail.com

Shoqëria Përmbarimore
"ZIKE" sh.p.k

Shoqëria Përmbarimore "ZIKE" sh.p.k, me adresë: Blv."Gjergj Fishta" Pallatet "Gora" Kulla 2, Kati 2, Ap 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-3, të pasurise të paluajtshme në pronësi z.Hajdar Sejdi Thaçi, si më poshtë:

- **Në date 30.01.2018 ora 16:45**

-Pasuri nr. 24/184+3-21, ZK 8512, lloji i pasurise (apartament) me siperfaqe. 96,6 m2, me adresa Durres, cmimi fillestar eshte 4,398,912 leke

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e
Tel. 044 500 278 ose adresën e e-mailit: ilirdervishi85@gmail.com

Atentat në Mitrovicë, vritet politikani serb Oliver Ivanoviç

U akuzua për krime lufte, por nuk ndiqte verbërisht politikën e Beogradit


Vendi ku ndodhi vrasja

Udhëheqësi i Nismës Qytetare serbe "Liri, Demokraci, Drejtësi", Oliver Ivanoviç, është qëlluar më armë zjarri mëngjesin e së martës në veriun e Mitrovicës. Zyrtarë të partisë së tij thanë se ai u qëllua para zyrës dhe më pas u dërgua në spitalin e Mitrovicës, por nuk u bëri ballë plagëve të marra. Drejtori i spitalit në veriun e Mitrovicës, Milan Ivanoviç, tha se janë konstatuar pesë plagë në kraharor, të shkaktuara nga armë zjarri. Mediet kosovare shkruajnë se 64-vjeçari vdiq në spital ku ishte dërguar me urgjencë, ndërsa sipas atyre serbe ai ka vdekur në vend e mjekët në spital kanë bërë ç'është e mundur për ta rikthyer në jetë, por pa sukses.

Policia nuk ka mundur të zbulojë autorët e atentatit. Makina e personave që shtinë mbi të është gjetur më vonë e djegur në Zveçan. Informacionet mbi sulmin nuk janë ende të plota, megjithatë, nga sa pohoi zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për Veriun, Besim Hoti, forcat policore janë angazhuar maksimalisht për gjetjen e agresorëve.


Oliver Ivanoviç

KUSH ISHTE IVANOVIÇ?

Oliver Ivanoviç ishte përfshirë në politikë që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Njohës i mirë i gjuhës shqipe, i diplomuar i Fakultetit të Inxhinjerisë Mekanike në Mitrovicë e më pas atij të Ekonomisë në Prishtinë, karrierën politike e nisi pikërisht gjatë luftës së Kosovës, kur u caktua president i Këshillit Kombëtar Serb për Veriun e Kosovës dhe Metohinë. Ai do të shndërrohej pas konfliktit në udhëheqësin kryesor të serbëve të Kosovës, duke sjellë një frymë të re në politikën serbe atje, që i entuziazmoi fillimisht ndërkombëtarët, për t'u shembur pastaj përdhe kur dolën në dritë akuzat për pjesëmarrje në masakrat kundër shqiptarëve.

Aktualisht viktima ishte duke u përballur me procesin gjyqësor për krime lufte, nën akuzën se kishte urdhëruar vrasje të shqiptarëve në Mitrovicë në vitin 1999. Aktpadia, të cilën ai e mohonte me pretendimin se ishte pa baza, e la dy vite prapa hekurave në paraburgim, përpara se të lirohej në muajin prill e ta priste në gjendje të lirë rezultatin e gjyqit.

Në muajin korrik 2017, makinës së Ivanoviçit i ishte vënë zjarri. Ai vetë ishte shprehur atëherë se nuk ishte përfshirë në biznese të paligjshme e nuk kishte armiq, por vetëm kundërshtarë politikë. Ivanoviç pati akuzuar ashpër Beogradin për mbështetjen e "Listës Serbe" në zgjedhjet e 22 tetorit të vitit të kaluar në Kosovë, e tha atëherë se ka ardhur një kohë që "serbët po frikësohen nga serbët, e jo nga shqiptarët".

Ndonëse kishte paralajmëruar pjesëmarrjen në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë të qershorit të vitit 2017, ai kishte hequr dorë për shkak të numrit të madh të subjekteve politike nga bashkësia serbe, duke thënë se kjo do të sillte shpërndarje të votave. Beogradi zyrtar, me këtë rast kishte mbështetur vetëm Listën Serbe.

Në fillim të vitit 2014, Ivanoviç ka qenë një prej kandidatëve për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut, kur edhe u arrestua. Në janar të vitit 2016, një gjykatë e drejtuar nga Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit e shpalli fajtor dhe e dënoi me nëntë vjet heqje lirie nën akuzat për "krime lufte kundër popullatës civile". Por në muajin shkurt të vitit 2017, çështja u kthye në rigjykim nga Gjykata e Apelit në Kosovë.

Ivanoviç la pas bashkëshorten Milena dhe katër fëmijë. Vrasja e liderit serb tronditi thellë politikën dhe mbarë opinionin publik, në Kosovë, Serbi dhe Ballkan. Por më të prekur nga ngjarja janë padyshim familjarët e Ivanoviçit. Mediat raportojnë se gruaja e tij, Milena, e ka pritur shumë keq lajmin për ekzekutimin e bashkëshortit. Ajo nuk ka mund ta përballojë këtë lajm të trishtë, duke përfunduar në spital, në gjendje të fikti. Milena shoqërohej nga kunati i saj në momentin kur ka marrë vesh lajmin e të shoqit. Ndërkohë, në një reagim të parë, ajo ka paralajmëruar vrasësit e bashkëshortit të saj se do ta paguajnë. "E rëndësishme është që fëmijët tanë janë mirë dhe tani janë me nënën time. Kush e ka bërë këtë, duhet ta dijë se nuk do të përfundojë mirë", është shprehur Milena, shkruan media serbe Kurir.

REAGIMET

Kosova, Shqipëria, ndërkombëtarët dënojnë ashpër dhunën

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dënoi ashpër vrasjen e kryetarit të Nismës Qytetare "Liria, Demokracia, Drejtësia", Oliver Ivanoviç. "I ftoj organet e rendit që t'i ndriçojnë sa më shpejtë rrethanat e vrasjes së tij dhe aktorët e krimit të dalin para drejtësisë", thuhet në reagimin e presidentit Thaçi, i cili u bën thirrje qytetarëve të të gjitha komuniteteve në veri të vendit që të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë për ndriçimin sa më të shpejtë të kësaj vrasjeje. Nga ana e saj, edhe qeveria e Kosovës dënoi ashpër vrasjen duke theksuar se "akti i vrasjes së Oliver Ivanoviçit sfidon sundimin e ligjit dhe çdo përpjekje për të vendosur rendin në gjithë territorin e Kosovës. Dhuna është e papranueshme pa marrë parasysh nga kush vjen dhe ndaj kujt drejtohet". Në reagimin e saj, qeveria u bën thirrje të gjithë qytetarët që të bashkëpunojnë me organet e rendit në zbardhjen e rastit dhe njëkohësisht nga mekanizmat e sigurisë kërkon që të kapin autorët e krimit dhe t'i sjellin ata përpara drejtësisë.

SHQIPËRIA

Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta shprehu keqardhjen e thellë dhe dënoi ashpër vrasjen e politikanit serb të Kosovës, Liderit të Iniciativës Qytetare "Liria, Demokracia dhe Drejtësia". Ai ka shprehur besimin se autoritetet do ta zbardhin sa më parë këtë akt kriminal dhe do të vënë përpara drejtësisë autorët. Meta bëri thirrje për vlerësimin e situatës me qetësi e maturi dhe që ky akt kriminal të mos ndikojë në procesin e rëndësishëm të dialogut midis Serbisë dhe Kosovës, në dobi të stabilitetit, paqes dhe sigurisë së rajonit. "Keqardhje e thellë për tragjedinë e Oliver Ivanoviç; akt qëllimkeq, që nxit urrejtje e tension. Përpjekjet për dialogun e paqen s'duhen ndalur! Duhen thelluar!", shkruajti në FB kryeministri Edi Rama. Kurse kreu i opozitës Lulzim Basha deklaroi se "Akti, përveçse një atentat ndaj jetës, synon të jetë një atentat ndaj proçeseve të bashkëjetesës e të dialogut në Kosovë. Trajtimi i ngjarjeve të tilla, kërkon maturi dhe largpamësi nga çdo aktor i përfshirë në dialogun dhe proçesin e paqëtimit në Kosovë".

Alarm në Serbi, Vuçiç e konsideron si sulm ndaj shtetit të tij

Beogradi tërheq menjëherë delegacionin e negociatave nga Brukseli

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, mblodhi dje me urgjencë në mesditë Këshillin Kombëtar të Sigurisë pas vrasjes së Oliver Ivanoviçit. Ai tha pas takimit se vrasja ishte "akt terrorist" dhe se u ka dërguar letër Misionit të Kombeve të Bashkuara dhe EULEX-it me kërkesën që organet serbe të përfshihen në hetime. "Nuk dua të spekuloj, por ka detaje interesante, që na çojnë tek autorët dhe kushdo që e ka kryer këtë akt, qoftë serb, shqiptar apo i huaj, do të përballet me drejtësinë", u shpreh Vuçiç.

Duke shtuar se Beogradi do të kryejë hetime të posaçme dhe do ta zbulojë se ç'ngjau, nëse këtë nuk e bëjnë autoritetet në Kosovë dhe do të publikojë identitetin e autorëve, pavarësisht nëse bëhet fjalë për shqiptarë apo serbë. "Autorët e këtij akti do të vihen para drejtësisë. Nëse ata që e kanë për detyrë nuk e bëjnë këtë, ne do ta bëjmë", tha ai.

PASOJAT

Pas vrasjes së Oliver Ivanoviçit, Serbia ndërpreu menjëherë bisedimet që nisën dje në Bruksel dhe u vendos kthimi urgjent i delegacionit në Beograd. E marta shënonte ditën e rifillimit të dialogut teknik Kosovë-Serbi, ku temat kryesore në diskutim ishin Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, lëvizja e lirë dhe Gjyqësori. Bashkimi Europian reagoi ndaj lajmit përmes Maja Koçijançiç, zëdhënëses së shefes së diplomacisë europiane, Federica Mogherini, që tha se BE e dënon me forcë këtë vrasje. Koçijançiç bëri thirrje që të gjitha palët në Kosovë të tregojnë qetësi e të përmbahen dhe që autoritetet përgjegjëse për sundimin e ligjit të kryejnë punën e tyre.

Ndërkohë, vetë shefja e diplomacisë europiane, Federica Mogherini i telefonoi presidentit serb Aleksander Vuçiç dhe atij të Kosovës, Hashim Thaçi, duke ua bërë të qartë se shpreson që autoritetet përkatëse të sundimit të ligjit në Kosovë nuk do të kursejnë përpjekjet për të gjetur autorët dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë.


Aleksandër Vuçiç

Duke komentuar lidhur me tërheqjen e delegacionit serb nga negociatat dypalëshe me Kosovën në Bruksel, Vuçiç deklaroi se "kur kemi kërcënime të përditshme, është e pakuptimtë dhe e vështirë që të dialogojmë".



RTK: Serbia do të dërgojë njësi speciale në Kosovë

Shërbimet inteligjente do të përgatitin trazira ndëretnike gjatë këtij viti

Instituti i Kosovës për Studime Ndërkombëtare ka informacione se Serbia është duke përgatitur plane për trazira në Kosovë gjatë vitit 2018, njoftoi dje Radiotelevizioni i Kosovës. "Sipas disa informacioneve, sigurimi shtetëror në Serbi ka themeluar një njësi të veçantë të quajtur "UJQIT", e cila do të realizojë një plan sekret operativ, ku do të organizohen aktivitete të dhunshme (trazira ndëretnike) në Kosovë".

Ky njësit është i themeluar enkas për këtë plan sekret operativ, me ç'rast janë përzgjedhur zyrtarë elitarë nga shërbimi inteligjent ushtarak si dhe ai policor. Ky plan operativ emërtohet "TOKA E SHENJTE" dhe do të drejtohet nga zyrtari i lartë Zoran Strakoviç me pseudonimin Zoki, i cili është nga fshati Zaskok - komuna e Ferizajt dhe i cili paralufte si dhe gjatë luftës ishte udhëheqës i lartë i sigurimit shtetëror serb, deri në largimin e forcave serbe nga Kosova. Aktualisht ai jeton në Beograd.

Sipas këtyre burimeve, ky njësit bazën kryesore e ka në Nish të Serbisë, por operon në gjithë territorin e Kosovës, ku dyshohet se ka 8 qendra të tjera. Ky njësit ka të angazhuar gjithsej 22 agjentë në bazën kryesore në Nish, të cilët edhe në të kaluarën kanë qenë pjesë e strukturave serbe të sigurisë, ushtarake dhe policore.

Ndërsa në Kosovë ka edhe 8 agjentë të tjerë nga komuniteti serb. Këto tetë qendra kanë gjithsej rreth 154 bashkëpunëtorë serbë dhe



joserbë. Për këtë plan operativ janë siguruar rreth 20 milionë euro.

Sipas këtyre informacioneve dyshohet se këta persona kanë për detyrë organizimin e aktiviteteve të dhunshme ndaj minoriteteve serbe në enklava apo mjedise të tjera, ku aktualisht ka qytetarë të komunitetit serb. Nga këto aktivitete dhune, ata synojnë të ndryshojë situata e sigurisë dhe jeta e serbeve që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë do të jetë e rrezikuar. Nisur nga ajo situatë, qeveria serbe do të kërkonte ndërprerjen e dialogut me Kosovën dhe do të kërkonte nga faktori ndërkombëtar riorganizim të funksionalizimit të institucioneve, të cilat iu takojnë serbëve, për të siguruar jetët e tyre nga nacionalistët shqiptarë, që janë duke udhëhequr Kosovën.

Sipas informacionit, qeveria serbe do të dalë me disa kërkesa ndaj ndërkombëtarëve dhe qeverisë së Kosovës në mënyrë që të krijohen kushte për vazhdimin e dialogut: Të themelohet një dhomë e parlamentit për komunitetin serb në Graçanicë për arsye sigurie; të zhvendoset kanali 2 i RTK-së në Graçanicë për arsye sigurie dhe të jetë i pavarur nga RTK; të krijohet drejtoria e policëve serbë në kuadër të PK; të krijohet batalioni i komunitetit serb brenda FSK në veri të Mitrovicës, që të komandohet nga një komandant serb.

Njësiti special synon të ndihmojë edhe gjykatën speciale në grumbullimin e informacioneve për krimet e shkaktuara nga UÇK pas luftës dhe gjatë luftës ndaj civilëve serbë dhe atyre shqiptarëve që ishin besnikë ndaj qeverisjes serbe deri më 8 qershor 1999.

Sipas RTK, ditët e fundit kanë filluar të riorganizohen pjesëtarë të të ashtuquajturës AKSH, sidomos në Besianë (Podujevë), Artan (Novobërd) dhe Kamenicë e Gjilan.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT - 2018

THIRRJE NR. 11 PER PROJEKTE

(11.01.2018- 12.02.2018)

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpall këtë Thirrje për Shprehje Interesi për të gjitha OJF- të e interesuara për projekte.

OJF-të janë të lutura t'i sjellin projekt-propozimet dorazi pranë zyrave të AMSHC-së në adresën: Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Godina e Observatorit, Kati II, Tiranë.

Projekt-Propozimet duhet të na dërgohen gjithashtu edhe elektronikisht vetëm në formatin word në adresën tonë e-mail: info@amshc.gov.al *(Në variantin elektronik nuk është e nevojshme firma dhe vula e skanuar)*.

Pas vlerësimeve të projekt-propozimeve, do të bëhet shpallja e projekteve fituese dhe do të nisë lidhja e kontratave.

Ftohen OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fushën prioritare:

Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjësuese dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera:

- Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;
- Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e margjinalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar,minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;
- Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarjet lokale dhe qëndrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;
- Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet inciaitivave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile;

Aplikuesit, persona juridike që janë regjistruar sipas ligjit dhe kryejnë veprimtari në përputhje me qëllimin e përcaktuar në statutin e tyre, kanë të drejtë të aplikojnë, konkurojnë dhe të paraqesin projekt- propozimet e tyre.

Formularin e aplikimit për projekt-propozime mund ta shkarkoni nga faqja jonë zyrtare në adresën: www.amshc.gov.al

Kohëzgjatja minimale e projekt- propozimeve do të jetë 6 (gjashtë) mujor ndërsa koha maksimale e tyre të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Afati i fundit kohor për dorëzimin vetëm dorazi si dhe me e-mail të projekt-propozimeve është dita e hënë, datë 12 Shkurt 2018 ora 16:30. Pas këtij afati nuk do të pranohet asnjë projekt-propozim.

Projekt-propozimet duhet të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

1. **Formulari i plotësuar i aplikimit**, i vulosur dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i Organizatës (Formulari duhet firmosur në çdo faqe);
2. **Vendimi i Gjykatës** dhe **Statuti** (të noterizuar) brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
3. **Ekstrakti i Gjykatës** (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Qarkut, Tiranë) – origjinal sa më pranë ditës së mbylljes së aplikimit;
4. **NIPT-i** (i noterizuar) brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
5. **Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave** (që Organizata nuk ka detyrime të pashlyera përsa u përket kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatim-taksat) - origjinal brënda afatit të Thirrjes;
6. **Vërtetim bankar** (ku pasqyrohen numri IBAN dhe numri i llogarisë së Organizatës, në lekë) - origjinal brënda afatit të Thirrjes;
7. **CV të Organizatës** (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF- së) dhe Licencën e lëshuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëse ka aktivitetete të parashikuara në projekt që nuk mund të kryhen pa zotëruar një Licencë të akorduar nga autoritet publike (për shembull: në rastet kur projekt-propozimet kanë aktivitete që kërkojnë ekspertizën e psikologut, ky i fundit duhet të ketë licensë për të kryer këtë funksion);
8. **Deklaratë/Marrëveshje Partneriteti** (origjinale ose fotokopje të noterizuar, në rast se ka partneritet në këtë projekt-propozim);

Vini re:

Në momentin e shqyrtimit të dosjes me projekt-propozimin/ et nga Komisioni i Posaçëm i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rast mungese të njërit prej dokumenteve të lartpërmendura, apo nëse nuk do të jetë në formën e kërkuar do skualifikohet.

Për pyetje në lidhje me këtë thirrje për projekt-propozime, ju lutemi na shkruani në adresën e-mail: info@amshc.gov.al

Adresa: Rr. "Frosina Plaku' Nr.58, Kati 2, Godina e Observatorit, Tiranë, Shqipëri. website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

Cyan magenta yellow black

Tronditet peshëngrita, Romela Begaj del pozitive me doping

Kampionia e Botës në mostrat e urinës ka rezultuar me substancën stanozolol. Trajneri: Analizat e gjakut të pastra, po favorizojnë amerikanen



To: Weightlifting Federation of Albania
Athlete: Ms. Romela Begaj
Date: 11/01/2018
E-mail: albanianweightliftingfed@hotmail.com
romelabegaj@hotmail.com

Subject: Notification of an Adverse Analytical Finding

Dear President/General Secretary,
Dear Ms. Begaj,

This is to inform you about the Adverse Analytical Finding as regards the urine sample provided by

Ms. Romela BEGAJ
(sample no. 160 14 70)

...n the occasion of an in-competition sample collection carried out by ...ing Federation at the IWF World Championships in Anaheim, ...oping Control Form)

...stanozolol (S1.1 Anabolic Agents)** was detected in the ...sis Report)

...urine sample constitutes an Anti-Doping Rule ...Anti-Doping Policy

...on has been granted to the Athlete ...onal Standard for Testing and ...at could cause the Adverse

...mple. Failing such ...aived. It is also the ...ntatives' right to be ... All costs arising from ...osts of the Athlete/the ...opening (incl. travel costs, ...deration

...ts of the "B" sample? ...no

If you answered with a "yes" to the above question, please specify:
1. Do you (the Athlete) wish to be present at the "B" sample opening at the Montreal Laboratory (Canada)? ☒ yes OR ☐ no
2. Do you (the Athlete) wish to send your representative to be present at the "B" sample opening at the Montreal Laboratory (Canada)? ☐ yes ☐ no
3. Does the representative of the Athlete's National Federation wish to attend the "B" sample opening at the Montreal Laboratory (Canada)? ☐ yes ☒ no

In case the analysis of the B sample is requested please inform our Secretariat in writing until 18 January 2018, please note that the Athlete may ask for copies of the A and B sample laboratory documentation packages which include information on the analyses as required by the International Standard for Laboratories.

In compliance with Article 7.9.1 of the IWF ADP

the Competitor is provisionally suspended from any weightlifting activity as of today (11 January 2018)

This provisional suspension remains in force until all applicable procedures are completed unless the Competitor accepts the "A" sample analytical results by waiving the requirement for "B" sample analysis and accepts the Adverse Analytical Finding bringing about the appropriate sanction.

The Athlete has the right to initiate a Hearing in front of the IWF Hearing Panel. Such request shall be in writing and delivered to the IWF Secretariat until **25 January 2018** the latest.

The Athlete may also request an expedited final hearing in line with Article 7.9.3 of the IWF ADP.

All costs of the Athlete and her representatives being present at the hearing are to be settled by the Athlete or her Federation. In case the IWF does not receive a written request for a hearing from the Athlete or through her Federation within the deadline above, the Athlete's right to request a hearing shall be considered waived.

The IWF wishes to provide the Athlete with an opportunity to submit a written explanation of the overall circumstances of the case or to dispute the IWF's assertion that an Anti-Doping Rule Violation has occurred until **21 January 2018**.

In line with Article 10.10.2 of the IWF ADP, the Athlete has the opportunity to promptly admit the Anti-Doping Rule Violation.

Tronditet sërish peshëngritja shqiptare. Kampionia e Botës në stilin e shkëputjes, Romela Begaj ka dalë pozitive në testet antidoping pas kampionatit Botëror të zhvilluar në Anaheim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ku mori dy medalje. Report Tv ka siguruar faksimilet e Federatës Botërore të Peshëngritjes ku i bën me dije Federatës Shqiptare se Romela Begaj ka rezultuar pozitive në mostrat e urinës me substancën stanozolol substancë për të cilën është pezulluar edhe tre vite më parë. Që nga data 11 janar peshëngritësja shqiptare është pezulluar nga çdo aktivitet deri në hapjen e testit B. Kampionia e Botës në shkëputje shprehet e bindur se është e pastër dhe ka kërkuar që të hapet testi B i analizës së urinës. Testi B do të hapet në Montreal të Kanadasë siç bën me dije Federata Botërore e Peshëngritjes dhe e pranishme do të jetë edhe Begaj së bashku me trajnerin dhe mjekun. Testi B do të vërtetojë nëse Romela Begaj ka përdorur apo jo substancën stanozolol e ndaluar nga Ëada. Federata Shqiptare e Peshëngritjes beson se sportistja është e pastër dhe për këtë rast do të flasë pasi të jetë bërë testi B. Në Botërorin e Anaheimit, Romela Begaj shënoi rezultatin më të mirë në karrierën e saj, pasi fitoi medaljen e artë në shkëputje dhe të argjendtën në dygarësh. Nëse testi B konfirmon përgjigjen e parë, atëherë dënimi për të, duek qenë përsëritëse, por edhe për vetë Federatën e Peshëngritjes, do të jetë shumë i rëndë.

Trajneri: Analizat e gjakut të pastra, po favorizojnë amerikanen

Pezullimi i Romela Begajt nga Federata Botërore e Peshëngritjes pasi rezultoi pozitive me doping, për trajnerin e peshëngritëses shqiptare është një skandal i kësaj federate. Gazmend Hakcani tha për Report Tv se gjitha kjo është lojë e Federatës Botërore për të favorizuar sportisten amerikane, e cila u rendit e treta në garën për titullin kampion bote. Ai sqaron se është e pamundur që një sportist të pezullohet dy herë për të njëjtën substancë. "Romela Begaj është e pastër. E gjitha është skandal i Federatës Botërore të Peshëngritjes. Kjo bëhet qëllimisht nga Federata botërore për të favorizuar peshëngritësen amerikane. E pamundur të pezullohesh 2 herë për të njëjtën substancë". Sipas tij, peshëngritësja shqiptare është e pastër nga çdo substancë e ndaluar. "Analizat në gjak të Begajt janë të pastra", tha Hakcani. Ky është pezullimi i dytë i Romela Begajt për doping. Edhe tre vite më parë ajo rezultoi pozitive në testet antidoping dhe u pezullua nga akvitietet sportive.



Kristal Abazaj

MERKATO

Kristal Abazaj pëlqehet nga Chievo në Serinë A

Ndërsa kanë kaluar vetëm 2 javë që kur Skënderbeu bleu kartonin e tij nga Luftëtari, Kristal Abazaj ka hyrë në orbitën evropiane të merkatos. Chievo Verona kërkon Kristal Abazajn e Luftëtarit. Lajmi i bujshëm publikohet nga prestigjiozja italiane Gazzetta Dello Sport, që u referohet zhvillimeve më të fundit te skuadra verdheblu. Edhe pse nuk jepen shumë detaje, mjafton fakti që një klub i Serisë A po sheh mundësinë e blerjes së një talenti nga Superiorja, që të përbëjë një lajm shumë të rëndësishëm për opinioinin sportive në vend. Abazaj që ka shkëlqyer në dy sezonet e fundit në radhët e Luftëtarit, pak ditë më parë konfirmoi se ka firmosur me Skënderbeun, por do të mbetet futbollist i Luftëtarit deri në fundit e sezonit në vijim. Abazaj ka deklaruar pak kohë më parë se synon që të pranojë një eksperiencë në Evropë. Pavarësisht se kartoni I lojtarit I përket Skënderbeut nga marrëveshja midis dy klubeve në rast shitje Luftëtari merr 20% të shumës.



Christos Athanasopulos

LUFTËTARI

Athanasopulos, një portier grek për gjirokastritët

Luftëtari vijon përgatitjet në Antalia, por vëmendja vazhdon të mbetet në merkato. Pas mbrojtësit Ivan Jakovljevic, presidenti Tavo ka gati një tjetër goditje në merkato. Drejtuesit e klubit konfirmojnë për Supersport se në parim është arritur marëveshja me portierin grek Christos Athanasopulos, ardhja e të cilit pritet më datë 20 Janar. Pikërisht atëherë është vendosur që të hidhet edhe firma në kontratë me 36-vjeçarin, duke përjashtuar këtu ndonjë surprizë të çasteve të fundit. Bluzinjtë nuk janë bindur nga forma e portierit elbasanas Amarildo Çekrezi, më të cilin kishin arritur një marëveshje. Por pas testimeve në tokën turke është arritur mirëkuptimi që palët të ndahen, duke bërë që gjirokastritët të zgjedhin pikërisht grekun Athanasopulos si alternativë të Shkëlzen Ruçit.

REAL MADRID

Dorëzohet Perez, pret ofertat për largimin e Ronaldos

Cristiano Ronaldo gjithnjë e më larg Realit të Madridit. Dëshira e 5-herë fituesit të Topit të Artë për t'i dhënë lamtumirën klubit merengues verën e ardhshme do të respektohet nga drejtuesit e Realit pasi presidenti Florentino duke u bazuar tek lajmet që raportojnë mediat portugeze i ka ndezur dritën jeshile agjentit të CR7-ës, Jorge Mendes për largimin e Ronaldos. Por edhe pse në shkurt sulmuesi luzitan do të mbushë 33-vjeç, Perez nuk do ta lërë Cristianon të largohet gati pasi i ka komunikuar Mendes-it që është gati të dëgjojë ofertat financiare të klubeve që janë të interesuara për lojtarin. Perez kërkon minimalisht 100 milionë euro për kartonin e Ronaldos. Dy skuadrat që interesohen më shumë për yllin portugez janë Manchester United dhe Paris Saint Germain nëse do të zgjedhë Djajtë e Kuq për Ronaldon do të bëhej fjalë për një rikthin në "teatrin e ëndrrave" aty ku u bë i famshëm si futbollist.



Cristiano Ronaldo

Flamurtari kallëzon Dukën në Prokurori për shoqatat fantazmë

Administratori Idrizi: 'Ky është vetëm hapi i parë'. FSHF po mundohet të regjistrojë shoqatat që të justifikojë votimin

Administratori i klubit të futbollit "Flamurtari", Sinan Idrizi, ka depozituar dje në Prokurori një kallëzim penal ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit. Kallëzimi ndaj FSHF-së vjen për shoqatat fantazmë, të cilat rezultojnë të paregjistruara në gjykatë. Pas dorëzimit të kallëzimit, Idrizi deklaroi për media se ky ishte hapi i parë i dukshëm dhe se do të ketë hapa të tjerë. Sipas tij, kallëzimi penal është bërë për që shoqatat e paligjshme. "Do bëj kallëzim penal për shoqatat fantazmë, shoqatat e paligjshme, pas njoftimit në media, që bëhet fjalë për një situatë të tillë. Janë 12 shoqata të paligjshme, pikërisht për këtë bëmë kallëzim penal. Fjalën e ka prokuroria tashmë, ky është hapi i parë i dukshëm ka edhe hapa të tjerë", deklaroi Idrizi.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Nr.27183/1 Prot. Tiranë, më 27.12.2017
Lënda: Përgjigje tuajës datë 18.12.2017
AV. FATION SHEHU
Tiranë
Në përgjigje të shkresës tuaj të datës 18.12.2017, ju sqarojmë se nga verifikimet e kryera pranë Zyrës së Organizatave Jofitmprurëse nuk figurojnë të regjistruara organizata me emërtimet:
1. Shoqata Rajonale Tiranë
2. Shoqata Rajonale Shkodër
3. Shoqata Rajonale Lezhë
4. Shoqata Rajonale Durrës
5. Shoqata Rajonale Elbasan
6. Shoqata Rajonale Fier
7. Shoqata Rajonale Korçë
8. Shoqata Rajonale Gjirokastër
Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.
KANCELAR
Donald XHELILI
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Nr.156/1 Prot. Tiranë, më 15.01.2018
Lënda: Përgjigje tuajës datë 08.01.2018
AV. FATION SHEHU
Tiranë
Në përgjigje të shkresës tuaj të datës 08.01.2018, ju sqarojmë se nga verifikimet e kryera pranë Zyrës së Organizatave Jofitmprurëse nuk figurojnë të regjistruara organizata me emërtimet:
1. Shoqata e Trajnerëve
2. Shoqata Mjekëve Sportivë
3. Shoqata e Arbitrave të Futbollit
4. Shoqata e Futsallit
Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.
KANCELAR
Donald XHELILI

FSHF TENTON REGJISTRIMIN E SHOQATAVE

Ndërkohë, FSHF thellon edhe më tej paligjshmërinë. Qeveria e futbollit në vend po mundohet t'i ligjshmërojë shoqatat fantazmë në gjykatë. Portali "vipsport.al" raporton se në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, dje është hedhur shorti për regjistrimin e katër prej këtyre shoqatave të cilat kanë të drejtë vote në Asamblenë e FSHF-së. Shoqata Rajonale e Futbollit Durrës, Shoqata Rajonale e Futbollit Lezhë, Shoqata Rajonale e Futbollit Fier dhe Shoqata Shqiptare e Minifutbollit po tentohet të regjistrohen nga FSHF për të thelluar edhe më shumë skandalin që i rrethon ato dhe votimin e tyre të jashtëligjshëm në Asamble.

SHOQATAT FANTAZMA

Ka disa ditë që ka plasur skandali i shoqatava fantazma që janë me të drejtë vote në Asamblenë Zgjedhore të FSHF-së. Fillimisht u vërtetua që 8 prej tyre nuk janë të regjistruara në gjykatë, ashtu siç e përcakton ligji dhe më pas të martën Bashkim Fino, kandidati për president i FSHF-së ka nxjerrë për publikun dokumentin e vërtetimit të mosregjistrimit edhe për 4 shoqatat e tjera. Bëhet fjalë për 12 shoqata, prej të cilave 8 janë shoqata rajonale: Shoqata Rajonale Tiranë, Shoqata Rajonale Shkodër, Shoqata Rajonale Lezhë, Shoqata Rajonale Durrës, Shoqata Rajonale Elbasan, Shoqata Rajonale Fier, Shoqata Rajonale Korçë, Shoqata Rajonale Gjirokastër. 3 janë shoqata që kanë lidhje direkte me aktivitetin si: Shoqata e Arbitrave, Shoqata e Trajnerëve dhe Shoqata e mjekeve sportive, ndërsa 1 është Shoqata e Futsallit. Sikur të mos mjaftonte kjo paregullsi ligjore, realisht këto shoqata janë pjesë e Federatës Shqiptare të Futbollit dhe njerëzit që i përfaqësojnë ato në Asamblenë Zgjedhore dhe që kanë të drejtën e votës, janë të punësuar ose bashkëpunëtorë të ngushtë të Federatës.

RËNDËSIA E VOTËS SË SHOQATAVE

Sipas statutit të Federatës Shqiptare të Futbollit më 7 shkurt në Durrës, Asambleja e Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore do të përbëhet nga 66 anëtarë me të drejtë vote. 54 janë klube sportive të gjithë kategorive të futbollit dhe 12 janë shoqata, prej të cilave 8 janë shoqata rajonale, 3 janë shoqatat e Arbitrave, Trajnerëve dhe e Mjekëve Sportiv, ndërsa 1 është Shoqata e Futsallit. Pra njerëzit që do të votojnë për këto 12 shoqata kanë pesëh shumë të madhe në garën që po zhvillohet për kreun e FSHF-së. Duke pasur këto 12 vota të sigurta Duka e nis shumë i avantazhuar garën përballë rivalit të tij Fino, i cili siç ka deklaruar publikisht nuk ka ndërmend që ta tolerojë këtë gjë. Fino ka deklaruar se kjo është shkelje e rëndë ligjore që ai nuk ka për ta toleruar dhe denoncimi që ka bërë klubi i Flamurtarit në Prokurori është mishërimi i kësaj deklarate. Tashmë duke se në betejën për presidencën e FSHF-së do të futen edhe organet ligjore duke e bërë edhe më të fortë dhe të paparashikueshme.


Sinan Idrizi

12 SHOQATAT E PAREGJISTRUARA NË GJYKATË

- Shoqata Rajonale Tiranë
- Shoqata Rajonale Shkodër
- Shoqata Rajonale Lezhë
- Shoqata Rajonale Durrës
- Shoqata Rajonale Elbasan
- Shoqata Rajonale Fier
- Shoqata Rajonale Korçë
- Shoqata Rajonale Gjirokastër
- Shoqata e Arbitrave
- Shoqata e Trajnerëve
- Shoqata e mjekeve sportive
- Shoqata e Futsallit

STATUTI

Mënyra e zgjedhjes së Presidentit

Për zgjedhjen e presidentit të FSHF-së kandidatët duhet të marrin 2/3 e votave. Nëse asnjë nuk e arrin këtë numër, dy kandidatët me më shume vota, zhvillojnë raund tjetër. Fiton ai që merr më shume vota. Nëse edhe në këtë rast nuk fiton askush, 24 orë më vonë mbahet një tjetër asamble, me votim tjetër. Ndërsa për anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, fitojnë ata që kanë 50 për qind plus 1 votë në raundin e parë. Nëse në raundin e parë nuk fitohet, zhvillohet i dyti dhe fitohet me shumicë të thjeshtë votash. Nëse sërish votat janë barabar, bëhet një raund i tretë dhe, nëse as ky nuk mjafton, anëtarët zgjidhen në bazë të shortit. Neni 13, Pika 2: Çdo kandidat propozohet nga të paktën një anëtar i FSHF-së, jo më vonë se 20 ditë para datës së asamblesë.

POSTIMI ONLINE


F.C.Flamurtari
3 orë ·
Skandali i rradhes eshte ne furre po piqet ndersa VIDEO eshte gati po pret urdhrin.
Me fakte te shkruara e zeza mbi te bardhe miliona euro,gjaku dhe djersa e femijeve te Shqiperise i marre peng,baste e shitje ndeshjesh ne Azi keto dhe jo vetem NE VAZHDIM...

Flamurtari paralajmëron FSHF-në: Gati denoncimi i basteve në Azi

Pas kallëzimit që administratori i klubit të futbollit 'Flamurtari', Sinan Idrizi depozitoi në Prokurori ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit, faqja zyrtare e klubit vlonjat në Facebook kërcënon me një tjetër skandal. Në një status në Facebook paralajmërohet një skandal në lidhje me shitjen e ndeshjeve në Azi përmes basteve. "Skandali i rradhës është në furrë po piqet ndërsa VIDEO është gati po pret urdhrin. Me fakte të shkruara e zeza mbi të bardhë miliona euro, gjaku dhe djersa e fëmijëve të Shqipërisë i marrë peng, baste e shitje ndeshjesh në Azi këto dhe jo vetëm NE VAZHDIM..." shkruhet në faqe.

Ndërsa dje paradite Sinan Idrizi bëri padinë për 12 shoqatat fantazmë, të cilat nuk figurojnë të regjistruara në gjykatë, por sipas FSHF kanë të drejtë vote në zgjedhjet e 7 shkurtit në garën mes Finos dhe Dukës për Presidentin e ri.





PROFECI E APOLLINAIRE:

KRUJA, KRYEQYTETI I LASHTE I SKENDERBEUT, THEMEL I NJE EUROPE TE RE

DATË PËRJETËSIE 17 JANARI 1468/ Autorë francezë për Skënderbeun. Një kolazh shkrimesh të shkëputura nga libri album "Skënderbeu, Album-Antologji, 1413-2017"...

FOTAQ ANDREA
TIRANE

"Skënderbeu, Album-Antologji, 1413-2017"

CHOISY, FRANÇOIS-TIMOLEON DE (1644-1724).

SKËNDERBEU, MBUROJA E KRISHTËRIMIT, HERO GJENIAL.

Kam ndjekur me një kënaqësi të madhe hap pas hapi Skënderbeun në rrjedhën e fitoreve të tij. Është një Hero i Krishterë që Providenca ia kundërvuri Heroit më të madh të turqve dhe që u quajt për aq kohë sa jetoi mburoja e Italisë, që pa të, kjo do të ishte shkretuar mbi një herë. Në ngjarjet e jetës së tij ndjehet Romaku. Por janë ngjarje aq pranë në kohë dhe të vërtetuara nga aq shumë autorë të të gjitha kombeve, sa nuk ka fije dyshimi.

Ai ishte i pashëm, me trup të përkryer, i shkathët në tërë ushtrimet dhe me një forcë aq të pazakontë sa në luftë a në ndeshje kurrkush nuk guxonte ta përballte.[...] Shumë shpejt ra në sy dhe tregoi sa aftësi, po aq edhe vlerë, Hero i ri që bënte me gjenialitet atë çka kapitenët më të vjetër e bënin falë përvojës.

Vdekja e Muratit e shpëtoi Shqipërinë. Papa shprehu gëzimin e tij duke i dërguar Skënderbeut një legatë dhe dhurata. Ladislasi, mbreti i Hungarisë, Duka i Burgonjës dhe Princër të tjerë i dërguan gjithashtu ambasadorë. Por Mbreti Alfons i Aragonës e i Napolit u dallua ndër miqtë e tij: veç një shume të madhe në të holla, i bëri dhuratë treqind mijë ngarkesa me grurë dhe njëqind mijë me tërshërë, gjë që arriti pikërisht në çastin e duhur në një vend të shkatërruar nga ushtritë e mëdha. [...]

Skënderbeu iu dorëzua dëshirës së shtetasve të tij, u martua me princeshën Donika, bija e Princit Arianiti, fqinj i Shqipërisë: bukuria dhe merita e saj e bënin të denjë për të qenë gruaja e një Heroi.

Lajmi i rënies së Kostandinopojës alarmoi tërë Princërit e Krishterë dhe i zgjoi nga përgjumja; u penduan që nuk kishin dërguar ndihma dhe pranuan pak më vonë se turqit duke mos u ndalur më në këtë pengesë, do të bashkonin pa vështirësi forcat e tyre të Azisë me ato të Europës dhe do të vazhdonin lehtë pushtimet e tyre. Papa Nikolla V, u përpoq të vendoste paqen midis Princave të Krishterë për të formuar një Kryqëzatë. Shihej qartë se turqit po mblidhnin tërë forcat për të nënshtruar Skënderbeun, Mbretin e Shqipërisë së vogël që i kishte ndalur për vite të tëra. E shihnin këtë princ si mburoja e Krishtërimit dhe e kuptonin më së miri se sikur turqit ta nënshtronin, së shpejti do të ndodheshin në Itali. Pal Engjëlli, Kryepeshkpi i Durrësit, këshilltari dhe miku i Skënderbeut, e shoqëronte këtë në tërë ekspeditat. Ky Prelat, tek i cili bashkoheshin një fisnikëri e lindur dhe një mendje e ndritur, një gojëtari që e ngrinte lart dhe një njohje e thellë e Shkrimit të shenjtë, e teologjisë dhe e Letrave të bukura, dhe sidomos një përshpirtshmëri e shëndoshë dhe zell i madh për Fenë, i kishte mësuar Skënderbeut greqishten e latinishten dhe e kishte arsimuar me themel në lëmin e doktrinës së krishterë. Nuk duhet çuditur që me cilësi të tilla të mëdha, ai ishte favoriti i Princit të tij.

Papa [Piu II] i dërgoi Skënderbeut shuma të mëdha në të holla dhe i shkroi se do vente vetë në Krujë për ta kurorëzuar Mbret të Shqipërisë, të Maqedonisë, Thrakisë e të Romanisë [Valakisë], duke e shpallur njëkohësisht Gjeneralisim të ushtrive të krishtera. [...] Skënderbeu sakaq po gatitej të hynte në Maqedoni, ndërkohë që mbreti i Persisë dhe Princërit e Karamanisë, të Sicilisë e të Kolkidës po mblidhnin trupat e tyre për të sulmuar turqit në Azi, dhe vetë duka i Burgonjës kishte premtuar të marshonte me një ushtri të sprovuar e të shumtë në numër; pra gjithçka dukej se ishte gati për Kryqëzatën e famshme, kur Papa, krejt i sëmurë siç ishte, u nis nga Roma për të shkuar në Ankona, nga ku do kalonte në Shqipëri.[...] Marazi, mosha dhe ethet goditën Papën [që] vdiq në moshën pesëdhjetë e tetë vjeçare, vitin e gjashtë të papatit të tij.

Më në fund Mehmeti, i xhindosur, erdhi vetë personalisht të rrethojë Krujën me njëqind e njëzet mijë vetë. Kishte nënshtruar perandorinë e Kostandinopojës, atë të Trebizondes, kishte detyruar pothuaj gjithë Princërit të shteteve fqinje t'i paguanin haraç.[...] Skënderbeu e shihte më së miri se vetëm me forcat e tij nuk mund të çante rrethimin. I shkroi Papës një letër fort prekëse:

[Letër e Skënderbeut për Papa Pavlin II].

"Mehmeti është zotëruesi i Azisë, dhe grekët, rashianët, tribaldët, ilirët janë nën zgjedhë; edhe Peloponezi është i nënshtruar dhe ai e ka plaçkitur njëzet herë Shqipërinë. Kam mbetur vetëm unë, At' i Shenjtë për t'i rezistuar me një grusht ushtarësh që nuk kanë më vend në trup për të marrë plagë të reja, dhe as gjak për të derdhur për Republikën e Krishterë. Ju e dini At' i Shenjtë që unë nuk jam kursyer dhe deri në çastin tim të fundit do të mbroj kauzën e Jezu Krishtit."

Mehmeti, tek mori vesh vdekjen e Skënderbeut, e harroi seriozitetin e vet dhe briti duke kërcyer nga gëzimi: "Kush do më pengojë tani për të shkatërruar të Krishterët, kur ata e humbën shpatën dhe mburojën e tyre".

POUQUEVILLE, FRANÇOIS CHARLES HUGES LAURENT (1770-1838).

LIDHJA E KRISHTERË QË BASHKOI SKËNDERBEU NËN FLAMUJT E KRYQIT MERITON TË KREMTOHET NGA NDONJË TORQUATO TASSO MODERN.

Dihet se historianët e Skënderbeut përcaktojnë si kufi të mbretërisë së këtij Princi Gjirin e Ambrakisë dhe Gjirin e Kotorit. I shtynë drejt Lindjes kufijtë e tij, gjer në Serbi, gjë që i jep më shumë shtrirje nga territori që ishte në vartësi të mbretit të Maqedonisë. Por duke lexuar historinë, vëmë re se ky princ kishte në të vërtetë në zotërim Krojën, Lisën, Dyrrahun dhe atë pjesë të Myzeqesë që shtrihet përgjatë bregut të djathtë të Apsusit. Pretendohet në të njëjtën kohë, se në cilësinë e tij si 'Ushtar i Jezu Krishtit' (titull që mbante), Skënderbeu ishte kryetar i një Lidhjeje, fisnikësh të fesë latine, që mbanin nën tituj të ndryshëm viset kryesore të Shqipërisë së Epërme. Në Veri ishin fisnikët e Zadrimës, rajon në përafri me liqenin Labeatis dhe me Daimën në Dardani. Përfshinte nga ana tjetër nën flamujt e tij Pal Dukagjinin, vëlla i Nikollës; fiset e pavarura të Shimerës [Himarës], baronët e Argiro-Kastronit, të Titit të Poshtëm

Cyan magenta yellow black

apo Titolisit, tani i quajtur Tebelen dhe të Komilës, kështjellë pranë Zhulatit. Në këtë katalog, nuk flitet për Artën, të cilën Siriaku i Ankonës e vizitonte pak a shumë në atë periudhë dhe që ai e quante Akarnani, as për Janinën, qytet atëherë i lulëzuar, edhe pse i pushtuar nga turqit.

Lidhja e krishterë që bashkoi Skënderbeu nën flamujt e Kryqit për të luftuar Amuratin, do e meritonte më së miri të kremtohej nga ndonjë Tasso modern, sepse të gjithë ata ishin të mëdhenj përpara Zotit, burra të lartë të asaj kohe për nga guximi dhe kreshnikëritë që bënë. Poeti na e thotë se si Ariamnites Thopia Golemi, luftëtar me origjinë të epërme dhe me autoritet të fuqishëm për shkak të fisnikërisë së stërgjyshërve të tij dhe zhdërvjelltësisë në artin e luftës, udhëhiqte skuadrilje të shumta kalorësie dhe batalione epirotësh të tmerrshëm për të pabesët. Ky princ, i shtrënguar t'i nënshtrohet Amuratit ishte shndërruar në haraçpagues për të pas marrjes së Janinës nga Kara Eurenozi që mësyu kundër tij dhe shkretoi viset e pasura përreth asaj qyteze me jetë të lulëzuar. Urrejtja e tij ndaj të pabesëve u gjallërua pas thirrjes së Skënderbeut, i cili e grishi për shpagim. Donte të rivendoste nderin e lashtë të Epirit që ishte nën urdhrat e tij nga Ausa gjer në Gjirin e Ambrakisë: ky hero mbante nofkën I Madhi tek epirotët dhe tek maqedonët, për shkak të përkushtimit të tij ndaj kauzës së shenjtë të Ungjillit e Kryqit.

Do tregonin, krahas tij, Andre Topinë, rreshtuar nën të njëjtët flamuj, i ndezur nga dëshira për të ndëshkuar Turkanin, i cili kishte shkretuar Myzeqenë dhe kishte therur një mori toksidësh [toskësh] duke ngritur pranë Avlonës një trofe pirgu me koka të prera të krishterësh. I ndritur për nga armët dhe mosha e kaluar, ky prijës shoqërohej nga të bijtë, Komani dhe Muzakeja, nga nipolli Tanusiosi [Tanushi], të parët e të cilit kishin themeluar Krojën dhe Petrelën. I ngrinte trupat në luftim në territorin e lëvizshmërisë së tyre midis Epidamnit dhe Tiranës së vogël.

Përreth këtij princi marshonin zotëruesit-fisnikë të Sturias [Skuria], Sherabit (Krabusit- Kërraba), Furkës (Farka), Shimarrës dhe Vlikës, rreshtuar nën flamurin e Gjergj Stresit, i biri i Balshajve. Gjoni dhe Bojku, vëllezër këta që kishin zotërime të pasura midis Krojës e Lisës parapëlqyen të rrinin mënjanë, në vatrat e tyre, për shkak të moshës së thyer që kishin.

Përveç këtyre kapitenëve, u bashkëngjitën edhe shumë të tjerë, bashkuar me zemër e gjuhë të përbashkët me Skënderbeun, si princërit Pal e Nikolla nga fisi i Dukagjinëve. Këta të fundit zotëronin përtej Drinit provincën që Skipëtarët e quanin Zadrima e epërme, rajon i gjerë që shtrihet gjer në Misinë e Lartë, e pasur në fruta, burime, lumenj, dhe e banuar nga racë njerëzish të ashpër.

Do paraqisnim në skenë po ashtu Luk [Lekë] Zaharinë, fisnikun e Zadrimës së epërme, që Drini - i krahasuar me Eridanin nga historiani i tij -, e lag me ujërat e veta; Pietro Hispanusin [Pjetër Spani], Aleksi Bosdarin, Uroshin dhe Miroshin, të bijtë e tyre, si dhe Luk Dumanin, tërë këta mbretër të cilëve u bindeshin peonët, pelagonët dhe skardët, pa harruar shumë qyteza përreth Drivastit [Drishtit] e Balezës, si dhe më në fund Zernovitch-in, princi sovran i Liburnisë, me fisnikët e vet të pathyeshëm të Venedikut.

Kështu, Skënderbeu ishte drejtuesi i një kondefederate të gjerë fisnikësh, sa sovran dhe mbret, në pranimin e zakonshëm të këtyre titujve augustë.



HOFFMAN, FRANÇOIS-BÉNOÎT (1760-1828).
SKËNDERBEU, I BARABARË ME ATA QË LASHTËSIA I BËRI GJYSMË-PERËNDI.

Skënderbeu ka qenë njeriu më i shquar i kohës së tij, dhe në një fushë-veprimi më të gjerë, do të kishte qenë i barabartë me ata që Lashtësia i bëri gjysmë-perëndi. Duhet të jesh tërësisht analfabet që të mos kesh lëçitur emrin e Skënderbeut.

ROHRBACHER, RENÉ FRANÇOIS (1789-1856).
HEROI I SHQIPËRISË MBROJTI I VETËM EUROPËN E KRISHTERË.

Me vdekjen e Huniadit, Europa e krishterë, ndër gjithë princërit e mbretërit, nuk gjeti veçse një të vetëm që kërkonte ta mbronte: ky ishte heroi i Shqipërisë. Kur Mehmeti II mori Kostandinopojën, në vitin 1453, dhe nënshtroi më pas Morenë, Skënderbeu, jo vetëm që nuk pyeti për tmerrin që kishte mbërthyer krejt krishtërimin, por, pa e shkuar kurrë ndër mend të rrinte në mbrojtje, vendosi, pasi grishi më kot princërit e krishterë për të bashkuar forcat nën udhëheqjen e tij, t'i shpallte i vetëm luftë sulltanit. U hodh në Maqedoni, në krye të tetë mijë vetëve, mori një numër kështjellash dhe spastroi fshatrat nga otomanët. Sulltani pretendoi se nuk donte të luftonte vetë ai kundër një kundërshtari aq të dobët, kur në fakt, ai trembej të përballej me një kapiten aq të madh. Tre vjet me radhë zëvendësit e tij më të mirë sulmuan Epirin në krye të ushtrive të shumta dhe tre vjet me radhë ata u mundën; Skënderbeu diti aq mirë të përfitonte nga thyerjet e terrenit dhe nga rrethanat që krijonte rastësia sa arriti t'i dërrmonte a t'i dëbonte tërë trupat që i kundërviheshin.

Vetëm një njeri i dërgonte ndihma dhe inkurajime; ky ishte papa Kaliksti me të cilin ai mbante letërkëmbim të vazhdueshëm. Më 1457, ky sovran i dërgoi një shumë të madhe të hollash nga të dhjetat e vjelura për kryqëzatën në viset përreth; krahas kësaj ndihme, i dërgoi edhe shumë galera me armatime. Në mënyrë të vazhdueshme e nxiste me letra, duke e njohur për mbrojtësin kryesor të krishtërimit, si dhe u bënte të ditur princërve të tjerë se në këtë mision ai po vepronte pothuaj i vetëm. Flota e papës komandohej nga Louis, kardinal patriark i Akilesë. Duke kombinuar veprimet e tij me ato të Skënderbeut, arriti mjaft suksese mbi turqit, mposhti flotën e tyre në çdo rast dhe u mori shumë ishuj, midis të tjerave ato të Mitilenës dhe Lesbosit. [...]

Duke ndjekur shembullin e paraardhësve të vet, Papa Pali II u përpoq fillimisht të gjente mjetet për të mposhtur fuqinë e osmanëve, ose



të paktën për të ndalur vazhdimin e pushtimeve të tyre në tokat e të krishterëve.[...]

Por, siç thonë autorët e asaj periudhe, as fitoret e turqve, as gjendja e mjerë e fesë, as lëvizjet që Pali II bëri gjatë drejtimit të Kishës për një objektiv aq të lavdishëm dhe një kauzë aq të drejtë nuk mundën të mposhtnin indiferentizmin e kreut [Perandorit Frederic IV] dhe të anëtarëve të Perandorisë. Do u duhej diçka nga shpirti i Skënderbeut. Ky njeri i madh, duke respektuar autoritetin e papa Palit II dhe kërkesat e Ferdinandit I, mbret Napolit, përshkoi Adriatikun me një korpus të përzgjedhur të trupave shqiptare dhe shkoi të çlirojë qytetin e Barit, ku Ferdinandi ishte i rrethuar; e rivendosi atë në zotërim të qytezës së Tranit dhe ndihmoi fuqimisht në fitoren që arriti ky sovran në Trojë më 18 gusht 1462 ndaj Jean d'Anjou, kundërshtari i tij. Shërbimet që i bëri Skënderbeu mbretit të Napolit iu shpërblyen nëpërmjet dhënies dhuratë të qytezave të Tranit, Sipontes dhe Saint-Jean-le-Rond.

Përherë triumfues ndaj armiqve të emrit të krishterë, Skënderbeu ngadhënjeu mbi ta dhe i detyroi të braktisnin me turp rrethimet. Shqipëria, provincë e varfër, e shkretuar, e padepërtueshme me grykat e veta, e mbrojtur nga një hero dhe nga ushtarë që shiheshin si të pathyeshëm, e turpëronte çdo ditë kryeneçë-sinë e Muhametit. Ai u përpoq shumë herë ta hiqte qafe Skënderbeun, dhe i bindur se nuk mund ta mposhtte dot, u orvat ta vriste, por tradhtia iu zbulua dhe vrasësit pësuan vuajtjen e fundit.

Ashtu si Godefroi de Bouillon, Skënderbeu kishte forcë trupore të jashtëzakonshme. I bashkohej kësaj force kalitur përmes sprovash, një guxim dhe gjallëri po aq të mahnitshme. Edhe pse Kruja ishte kryeqyteti i shteteve të tij, ai banonte rrallë aty dhe nuk kishte, të themi, vendqëndrim të ngulur, por ndodhej kudo ku ishte e nevojshme prania e tij. Përpara armikut, ditë e natë, ai ishte mbi kalë; herë në terren të zbuluar, herë në fushim, duke inspektuar një për një trupat dhe duke u siguruar për gatishmërinë e tyre të lartë, ai ishte përherë i pari në luftë dhe i fundit në tërheqje; nuk kishte pikë fronti ku ai të mos ndodhej e të mos luftonte si ushtar i thjeshtë. Ky guxim i shpalosur është i domosdoshëm për të ndezur shpirtin luftarak të trupave dhe nuk e pengonte të zotëronte tërë cilësitë e një gjenerali të shkëlqyer. Edhe pse i ashpër në fushën e disiplinës ushtarake, popullariteti që gëzonte, shpirtmadhësia dhe bujaria që e karakterizonin e kishin shndërruar në idhull në sytë e ushtarëve të tij; ishte tmerri i turqve, që gjithnjë i kishte mposhtur gjatë njëzet e tre vjetëve dhe mbi njëzet e dy beteja, në një kohë kur mbarë Europa dridhej para tyre dhe kur fuqia e tyre kishte arritur kulmin. Ai me siguri do ta kishte penguar marrjen e Kostandinopojës dhe do t'i kishte ngritur digë fuqisë osmane, nëse fuqitë e krishtera dhe veçanërisht venedikasit do ta kishin ndihmuar me trupa e me financë atë luftëtar aq sypatrembur sa ç'ishte Heroi Shqiptar.

APOLLINAIRE, GUILLAUME (1880-1918).
KRUJA, KRYEQYTETI I LASHTË I SKËNDERBEUT, THEMEL I NJË EUROPE TË RE.

Çështja shqiptare u duket diplomatëve që rregullojnë fatet e botës, tepër e vogël në krahasim me çështjet tepër të mëdha që i detyrohen vëmendjes së Gjithësisë së tronditur.

Diplomatët e mëdhenj ndoshta gabohen.

Ndoshta, krejt të habitur, do venë një ditë në Janinë a Krujë, kryeqyteti i lashtë i Skënderbeut, të vendosin, me dorë të pasigurt, themelet e një Europe të re.

Cyan magenta yellow black

Trashgimtarët, kush pritet të mos marrë dëmshpërblimin

Ndërpritet procesi i dëmshpërblimeve. Skemat që po diskutohen për ish të përndjekurit politikë

Paralajmërimi i Ministrit të Financave Arben Ahemtaj, se do të rishikohet skema për dëmshpërblimin e trashgimtarëve, ka zbuluar edhe disa nga skemat që po mendohet për dhënien e dëmshpërblimint për ish të përndjekurit. Gazeta mëson se qëllimi i Financave është të përjashtojë nga skema përfituesit e radhës së dytë e të tretë. Kjo do të thotë se dëmshpërblimin si trashgimtarë mund ta marrin vetëm fëmijët e atyre që kanë qënë në burg. Gjithashtu Ministria e Financave bën me dije se do të përqëndrojë të gjithë fondin tek trashgimtarët e radhës së parë. Nisma kërkon edhe ndryshime ligjore, të cilat po hartohen nga ekspertët. Pra të gjithë fëmijët e personave që kanë qënë të burgosur do të marrin dëmshpërblimin, por jo fëmijët e fëmijëve dhe kështu me radhe. Në total janë rreth 12 mijë persona që përjashtohen nga skema e dëmshpërblimit, por numri pritet të rritet më shumë në vitet në vijim.

12 mijë
Personave që kanë qënë të burgosur do të marrin dëmshpërblimin, por jo fëmijët e fëmijëve dhe kështu me radhe. Në total janë rreth 12 mijë persona që përjashtohen nga skema e dëmshpërblimit.

Ligji
Me shlyerjen përfundimtare të dëmshpërblimit të subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara sipas këtij neni, i gjithë buxheti vjetor kalon për dëmshpërblimin e trashë-gimtarëve



NDRYSHIMET

Janë të nevojshme edhe ndryshimet në ligjin për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politik. Kjo për faktin se është dhënë kësti i tetë për të gjithë ish të dënuarit që janë gjallë dhe 70% e fondit shkonte për ta. Tashmë duhet që të ketë një rishpërndarje të fondeve vetëm për trashgimtarët. Sipas burimeve të gazetës nga Ministria e Financave ndryshimet ligjore që pritet të bëhen, do të ndërpresin edhe dhënien e kështit të parë dhe të dytë për trashgimtarët.

MINISTRI AHMETAJ

"Për trashëgimtarët ka një këndvështrim të ri, që diskutohet brenda qeverisë dhe po deri në vendimmarrje, ai fond për përfituesit trashëgimtarë ka ngrirë deri në një moment kur të kemi qartë politikën, pra do të shlyejmë këstet e të gjithë trashëgi-mtarëve, nuk ka rëndësi brezi i parë, i dytë apo i katërt apo do të kufizojmë. Ka një këndvështrim të ri që diskutohet brenda qeverisë: do t'i shlyejmë të gjithë, brezin e dytë, brezin e tretë, brezin e katërt pambarim, apo do kufizohemi!", tha ministri i Financave dhe Ekonomisë dy ditë më parë.

ÇFARË PARASHIKON LIGJI?

"Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit për të ish-të dënuarit politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale, në një raport prej 70 për qind për të gjitha kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni dhe 30 për qind për trashëgimtarët e ish-të dënuarve, që nuk bëjnë pjesë në këtë kategori, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i vogël se 100 000 lekë dhe jo më i madh se 1 000 000. Me shlyerjen përfundimtare të dëmshpërblimit të subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara sipas këtij neni, i gjithë buxheti vjetor kalon për dëmshpërblimin e trashë-gimtarëve të ish-të dënuarve politikë", – thuhet në ligj e ndryshuar në vitin 2014.

PARALAJMËRIMI

Pagat, naftëtarët e ARMO-s: Po s'gjetëm zgjidhje, sërish në Tiranë



Naftëtarët e rafinerisë së ARMO-s në Ballsh, paralajmërojnë se do udhëtojnë sërish drejt Tiranës nëse nuk gjejnë zgjidhje për pagat e prapambetura. Ndërsa janë paguar për muajin nëntor, pagë e cila kaloi në llogarinë e naftëtarëve pas protestës së tyre në Tiranë, në fund të 2017-ës, nuk dihet se kur do marrin pagën e dhjetorit. "U paguam për muajin nëntor, por s'kemi marrë pagën e dhjetorit. Na kanë thënë që s'dihet kur do e marrim. Kemi kërkuar takim me Prefektin. Në rast se nuk gjejmë zgjidhje, do udhëtojmë sërish drejt Tiranës", paralajmëruan naftëtarët e ARMO-s. Ndërkohë, naftëtarët kanë të prapambetura pagat e 12 muajve të mbartura vite më parë. E gjithë kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë e borxheve të kompanisë ARMO për shkak të keqmenaxhimit të saj.

UNIVERSITETET

Studentët protestojnë më 24 janar, tarifat e larta të shkollimit

Studentët e disa universiteteve të Tiranës janë angazhuar ditët e fundit për plotësimin e një peticioni kundër tarifave të larta të shkollimit drejtuar qeverisë, ndërsa më 24 janar do të protestojnë para kryeministrisë.

Thirrja e studentëve:

BASHKOHU, NDIHMO ME PETICIONIN E SHPËRNDA LAJMIN PËR PROTESTËN!

Grupe studentësh janë angazhuar ditët e fundit në fakultete të ndryshme, kryesisht të Universitetit të Tiranës dhe atij Politeknik, për të grumbulluar nënshkrime për peticionin, drejtuar qeverisë, me kërkesat e mëposhtme:

– Të përgjysmohen tarifat studimore në të gjitha degët dhe nivelet e studimeve;

– Të hiqet barra financiare për certifikimin e gjuhës së huaj;

– Të hiqet pagesa dyfish e krediteve për provimet e mbartura;

Ndërsa në Fakultetin Gjeologji Miniera është nënshkruar edhe një peticion i dytë:

– për kthimin e godinës së fakultetit në pronësi të fakultetit.

Deri më tani janë grumbulluar me mijëra nënshkrime për këto kërkesa të drejta e të realizueshme.

Aksioni për nënshkrimin e peticionit do vijojë edhe këtë javë, dhe do të kulmojë me protestën e 24 janarit në orën 11.00, nga Korpusi drejt kryeministrisë.

Bashkohu!



[OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.con kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme :

TË KETË ARSIM TË LARTË

VLERËSOHET TË KETË NJOHURI TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË KETË PËRVOJË PUNE

TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TEREN

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË KËTË ADRESË:
marketing@shqiptarja.com

[SH.com]

PARADË FJALËKRYQESH



NGA **KADRI VOKOPOLA**

FJALËKRYQI **PA SKEMË**

DUHET TË NXINI **34** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

1. Kufijtë e pjesës
-Nganjëherë nuk e vlen qiranë.
-Fare pa fe.
2. Dix që qe piktor.
-Babaliu këngëtare.
-Carlos, apache i futbollit.
3. Qe mbreti i 300 spartanëve.
-Dacia shkrimtare italiane.
4. Resnais që qe regjisor.
-Mbeten në filtër të tilla.
5. Munnd të jetë i rrallë.
-Janë sportivë të tillë si Ismet Bellova.
6. Fillojnë tatëpjetën
-Kanë organizatën Hamas
7. Mbyllin komentin.
-Është brinjë në skuadër.
-Eshtë edhe ai i mëngjesit.
8. Një futje me trehapësh nën kosh.
-Luan në shtëpi në Niko Dovana.
-Mirë në qendër.
9. Janë edhe ato elektrike.
-Një fazë gjumi.
10. Ekstreme në model
-Janë kapriçiot.
- Ishte Porta e Sulltanit.
11. Shpenzoheshin nga spanjollët dikur.
-Kryeqyteti i Marokut.
12. Janë trupa pa kënde .
-Eshtë ushtari i partisë.

VERTIKAL

1. Një shumëkombëshe amerikane në fushën e fotografisë.
-Një thirrje parandalluese.
2. Një birrë e jona.
-Armstrong që shkeli i pari nëq Hënë.
3. Një fetë buke e thekur.
-Paul Newman.
-Kështu fillon periudha.
4. Isla... e Madonna-s.
-Gruaja e Ben Hur.
5. Pak iniciative.
-Teket e korit.
-Derisa janë në fund.
6. ... Hot Chili Peppers.
-Mund të bëhen puré.
7. Rrallë është përgjysmë.
-Janë mizorë.
8. Inicialet e Moravia-s.
-Mund të degjenerojnë në sherr
9. Janë teologë në xhami.
-Gjysmë master.
10. Janë paudhësi çamarrokësh.
11. Kush është... është dorëzanë.
-Është anestetik.
12. Adriana aktore italian.
-Lëvizje Autonome Lokale.
13. Ishin gjigantë si Hiperioni.
-Gabim pa ekstreme.
14. Ishte Lerna.
-Mund të jënë kokosi.
15. Është sëmudje infektive
-James që thirrej Miss Peaches.
16. Inicialet e Einstein.
-Të jashtëzaknshme të tilla të Edgar Allan Poe.
17. Inicialet e Zemeckis regjisor.
-Kush është... do të pijë.
-Kufizojnë këndet.
18. Mbyllin fushatat.
-Igli te Lazio.
-Arte pa re.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

D	E	R	M	A	T	O	L	O	G	■	B	A	V	■	T	K	
O	R	A	■	R	R	A	S	A	■	H	A	■	E	R	E	■	
L	■	S	A	M	■	Z	I	■	V	E	T	■	R	E	R	A	
L	E	T	R	A	R	E	■	T	E	L	E	G	R	A	M	E	
A	R	I	A	N	E	■	M	A	T	E	R	I	A	L	E	T	
P	I	■	M	I	■	K	O	M	U	N	I	S	T	E	T	■	
E	C	O	■	■	M	A	N	A	R	■	A	E	T	■	■	K	
T	■	■	K	H	E	D	I	R	A	■	■	L	I	A	N	E	
■	A	S	P	I	R	A	T	A	T	■	E	L	■	K	A	M	
A	C	E	■	M	I	R	O	■	■	A	L	E	A	T	■	B	
M	E	R	I	■	T	E	R	I	T	A	L	■	T	I	M	E	
P	R	E	D	H	A	■	E	P	I	T	E	T	■	V	O	T	

FJALËKRYQI **SPORTIV**



					1	■	2	■	3	4	5	■	6	7			
			8		■	9			■	10		■	11				
		12						■	13			14					
		15			■	16		17					■				
18	19	■	20	21				22				■	23			■	
24			■	25					■	■	■	26		■	27		
28		■	29				■	■	30	31	32						
	■	33	■	■	■	■	■	■	34								
35	36		37	38	39	40	41	42	■	■	43		■				
44									■	45			■				



HORIZONTAL

1. Fillojnë kalimin.
3. Një fjalë sio sipër.
6. Hapin serinë.
8. Në krye të detyrës.
9. Roth aktor.
10. Janë në qendër.
11. Janë në temë.
12. Shakohoxha telekronist.
13. Merret me të bukurën.
15. Me të bëjnë trarë.
16. Alexis te Arsenal.
18. Fillojnë vallen.
20. Një kosh nga distanca.
23. Kurora pa zanore
24. Është edhe ajo mistral.
25. Mund të jetë cirku.
26. Kalime në ekstreme.
27. Pak amoralitet.
28. Fillojnë nisjen.
29. Kusturica regjisor
30. Sergio te Real Madrid.
34. Është i lartë ai i kampionit.
35. Traineri në foto.
43. Tom Hanks.
44. Traineri në foto
45. Është ylli i skuadrës

VERTIKAL

1. Një garë garë çiklizmi japoneze
2. Zona me aeroportin Nënë Tereza.
4. Janë komunitetet.
5. Skuadër italiane
6. Një lojë me games.
7. Sanchez ish-tenist.
8. Një vegër për të korrur.
9. Ela e volejbollit.
12. Ka brirë piktoreskë.
13. Inicialet e Cantona.
14. Pound që qe poet.
17. Ndodh në kufij.
18. Një mund të jetë i formës së prerë
19. Është për medaljen e kampionit.
21. Memoria në computer.
22. Fillojnë kapjen.
26. Është tripikësh nga distanca.
30. Mbyllin një hark.
31. Oerter që hidhte diskun.
32. Hummels mbrojtës.
33. Titulli i Alex Ferguson.
36. Fillojnë lidhjen.
37. Unë dhe ti
38. Në hyrje të repartit.
39. Ekstreme në duel.
40. Pastaj në fund.
41. Mohim i prerë.
42. Janë në masë.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



A	P	E	L	■	P	■	T	■	D	R	A	M	A	
L	E	O	■	H	I	P	O	D	R	O	M	E	T	
■	R	■	V	E	R	O	N	I	C	A	■	D	A	
■	P	G	■	M	A	R	E	K	■	L	L	E	■	
T	■	K	A	L	A	R	I	■	T	T	R	■	A	D	E	T	I	
A	B	■	P	E	R	E	N	D	I	A	■	G	L	■	T	■	L	
N	A	■	B	R	A	G	A	■	■	T	B	■	E	■	■	■	■	
I	S	A	■	■	■	■	■	T	■	E	A	T	■	■	■	■	■	
■	T	■	L	U	I	S	S	U	A	R	E	Z	■	■	■	■	■	
L	I	O	N	E	L	M	E	S	S	I	■	A	■	■	■	■	■	



SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

PËRGJIGJE

8	3	4	1	5	7	2	9	6
5	2	1	8	6	9	4	7	3
6	9	7	3	2	4	1	5	8
1	6	5	2	9	3	7	8	4
7	8	3	6	4	5	9	2	1
2	4	9	7	1	8	3	6	5
4	7	8	5	3	2	6	1	9
3	1	2	9	8	6	5	4	7
9	5	6	4	7	1	8	3	2

4			3	2	7			5
	1	5				3	2	
2	3		1		8		9	6
			8		6			
	4	3		1		6	8	
			2		4			
1	7		6		2		4	3
	8	4				2	6	
5			9	4	3			8

HOROSKOPI

DASHI

Hëna kalon nëpër Bricjap sot dhe kjo do ju bëjë të ndjeni disa momente lodhjeje dhe të përfshiheni në diskutime të vogla me personin që keni në krah të cilat do t'ju shqetësojnë. Beqarët do të bëjnë një ekzaminim të ndërgjegjes dhe të kuptojë mirë llogaritë e tyre! Në punë jeni të hutuar nga shumë interesa, përpiquni t'i jepni peshën e duhur gjërave dhe të plotësoni angazhimet e filluara.

DEMI

Një ditë e kënaqshme nga shumë pikëpamje. Në dashuri zemra fluturon, erosi nuk do mungojë dhe ju vështirë se mund ta kontrolloni atë. Mbrëmje intime me partnerin/en! Beqarët do të duhet të jenë mirë me komunikimin në qoftë se duan të bindin dikë që të jetë në anën e tyre. Në aspektin profesional ju keni shumë projekte të reja që do të kryeni në ekip me të tjerët.

BINJAKËT

Luaj letrat e tua në paqe të plotë me mendjen. Sot dashuria fiton pikë dhe do t'ju lejojë të kaloni një ditë fantastike me partnerin/en! Beqarët do të gëzojnë favore të veçanta yjore që nuk do të dështojnë për të zbuluar veten në gjithë shkëlqimin e tyre. Në punë sot mund të keni një intuitë fituese që do t'ju lejojë të merrni një fitim të papritur!

GAFORRJA

Hëna në Bricjap është mjaft armiqësore dhe kundërshtimet me personin që keni në krah do të rriten. Përdorni durim dhe mirëkuptim në qoftë se nuk dëshironi që diçka të prishet. Zemrat e vetmuara duhet të jenë të kujdesshme për të mos u nisur në aventura dhe histori të komplikuara. Disa dhimbje koke në punë mund t'ju shqetësojnë, sidomos ju që doni të arrini rezultate të mahnitshme.

LUANI

Planet sentimentale nuk po ecin dhe kjo sjellë probleme dhe shqetësim në familjen tuaj, por mos u shqetësoni, stuhia do të ketë përfunduar deri në fund të javës. Një ditë aspak entuziaste edhe për ata që janë vetëm, nuk do kenë dëshirë të dalin apo argëtohen me miqtë. Në punë do të jepni më të mirën. Vazhdoni në rrugën tuaj.

VIRGJËRESHA

Sot ju mund të mbështeteni në një planet të bukur të ngritur në favorin tuaj. Mbrëmja është ideale për t'u çlodhur, për të shijuar gëzimet e familjes ose për t'u argëtuar me miqtë. Për beqarët, lajm i mirë po vjen për dashurinë, dikush do të vjedhë zemrën tuaj! Përvishni mëngët dhe jepni më të mirën prej jush, puna ju ofron mundësi të bukura për të konsoliduar pozicionin tuaj.

PESHORJA

Yjet nuk janë shumë në favorin tuaj dhe keqkuptimet me partnerin/en prishin disi marrëdhënien tuaj në çift. Shmangni dialogun në çështje me rëndësi të vogël! Do të jetë një ditë shumë e mirë për beqarët, shumë do të kenë shumë për të bërë, duke pasur parasysh programet e reja. Diçka në punë nuk funksionon ashtu siç dëshironi ose se si të tjerët presin nga ju.

AKREPI

Në fushën e dashurisë, shmangni dyshimet pa baza. Më mirë veproni me vetëdije dhe me siguri, veçanërisht ata që duhet të planifikojnë disa hapa të rëndësishëm në marrëdhënien e tyre në çift. Për ata që janë vetëm do të ketë shanse të mira për të takuar njerëz të sinqertë. Aktiviteti profesional mbrohet nga yjet. Hidhni veten pa hezitim në punë, përparime dhe ndryshime në pozitë.

SHIGJETARI

Sfera private është e qetë, për momentin nuk ka surpriza dhe nuk ka nevojë të shikoni përreth! Nëse jeni vetëm sot ju do të keni mundësinë për të afruar një person që ju pëlqen, por mos e humbni kohën, mund të jeni vonë! Në punë, vlerësoni situatën dhe prisni kohë më të mira. Në këtë mënyrë ju do të jeni në gjendje të shënoni fitimet tuaja!

BRICJAPI

Dita fillon me Hënën në shenjë dhe yje të favorshëm, të cilat lënë mënjanë përtacinë dhe pavendosmërinë që shpesh ju pengon të shijoni gjërat e mira që keni në jetë. Ditë e mirë edhe për beqarët të cilët do të kenë njohje të reja. Ju presin momente shumë interesante në punë, do të keni mundësi të përfundoni disa negociata.

UJORI

Hëna në fushën e dymbëdhjetë mund ta trazojë disi marrëdhënien tuaj në çift. Kjo gjendje mund ta vendosë jetën tuaj dashurore në merak. Beqarët do të duhet të kapin në ajër pretendimet e një personi, në qoftë se nuk dëshironi të largohet prej jush. Momente të lodhjes do ju shoqërojnë në punë, por do jeni të kënaqur me atë që keni arritur.

PESHQIT

Një diskutim i vogël mund të shkundë madje edhe çiftet më të forta, do t'u rezistojnë atyre vetëm ata që me të vërtetë duhen. Beqarët do të kenë një përjetim të jashtëzakonshëm emocional dhe do të jenë në dispozicion për të ndihmuar të tjerët. Mbaj parasysh financat, ndoshta keni shpenzuar më shumë sesa duhet dhe kjo mund të sjellë tronditje.

PËRGJIGJE

D	E	T	I	■	■	■	M	A	F	■	P	U		
E	C	E	■	D	■	R	E	■	A	D	E	T		
M	O	■	F	E	D	E	R	A	T	A	T	■		
O	■	D	E	F	I	C	I	T	A	R	E	■		
N	D	E	R	I	M	E	T	■	L	■	R	C		
E	■	F	R	■	E	T	A	■	I	■	P	A		
T	■	E	A	■	N	A	T	■	S	T	A	R		
■	F	K	T	■	S	T	■	S	T	■	N	L		
F	A	T	■	A	I	■	O	D	E	T	■	O		
■	R	E	D	F	O	R	D	■	T	■	U	S		
T	I	T	O	■	N	D	E	R	■	U	R	■		
C	A	■	R	U	I	■	R	U	D	O	L	F		

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALEKRYQI

I KRIPTOGRAFUAR

12B	2R	3E	13Z	■	5	1	8	5	3	4	1	4	■	
2	7	10	1	5	■	8	4	7	10	6	4	3	■	
1	13	7	■	2	7	■	■	11	6	14	1	2	3	
■	3	■	15	1	12	1	2	3	4	■	10	3	13	
1	■	12	1	4	3	2	6	4	3	■	1	13	2	
4	2	6	11	3	2	6	4	3	■	■	14	6	1	
1	2	4	16	2	7	16	6	■	11	6	4	4	■	
■	1	2	8	3	14	■	■	3	4	■	1	■	■	
18	19	1	■	4	■	19	6	4	1	2	■	15	5	
8	1	5	3	■	18	6	2	1	4	3	2	6	1	
■	5	16	1	10	6	4	3	4	6	■	3	18	7	
10	3	■	18	7	13	1	■	■	5	1	13	1	14	

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP ;** Aurel PEPA ***KRYEREDAKTOR***
Genc KONDI ***ADMINISTRATOR I PËRGJITHSHËM*** ; Admirina PEÇI ***KRYEREDAKTORE E "RILINDASI" ;***
GRAPHIC DESIGN: Altin ALIAJ, ***SHPËRNDARJA:*** Spiro MESHINI ***CEL:*** +355696088847

Departamenti i Marketingut:
Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. ***E mail:*** shqiptarja.com@hotmail.com ***Website:*** www.shqiptarja.com ***Mobile:*** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR!
THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!

BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War



Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 16:00 *të hënë & të martë pushim*

BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 18:00 *çdo ditë*

www.bunkart.al / info@bunkart.al
Prenotime / Reservations: +355 (0) 67 20 72 905